



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë
Master i Shkencave në “Shkenca Politike - Integrimi dhe
Qeverisja”
i Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD. Gert Guri

2. Assoc. Prof. Dr. Islam Jusufi

Dhjetor/2022

Për Programin e studimit Master i Shkencave “Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja ofruar nga Insitucioni i Arsimit të lartë Universiteti i Tiranës


| | | |
|-----|---|---|
| Nr. | | |
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave Politike |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave “ Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja ” |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR nr.303, datë 01.06.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASR nr.348, datë 25.11.2019 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike/4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 7 PAE/ 0 PAK v.a. 2018-2019 7 PAE/ 0 PAK v.a 2019-2020 7 PAE/ 0 PAK v.a 2020-2021 |
| 18 | Numri i studentëve: | studentë v.a. 2018-2019 studentë v.a 2019-2020 studentë v.a 2020-2021 *institucioni nuk ka vendosur në dispozicion evidenca në lidhje me këtë pikë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi i përbashkët i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike – Integrimi dhe Qeverisja”, është i licencuar me Urdhër të Ministrit Nr. 302, datë 01.06.2013, si programi i ciklit të dytë, Master i Shkencave, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Programi i studimit realizohet në partnerit me universitete Evropiane dhe në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët nga 2 deri në 4 institucione partnere të konsorciumit. Programi i studimit, i ofron studentit aftësim, kompetencë dhe njohuri të domosdoshme veçanërisht në aspekte të cilat kanë të bëjnë me njohjen, kuptimin dhe analizën e proceseve integruese dhe qeverisëse nëpërmjet ndërthurjes së koncepteve teorike me metodat e avancuara të kërkimit shkencor, orëve të mësimit në auditor me punën shkencore të pavarur, si dhe expertizës vendase me atë të huaj, duke i mundësuar studentit vazhdimin e një karriere të mëtejshme akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kurrikula e programit të përbashkët të studimit ofron 5 module (specifikisht Teoria Politike, Politika Krahasuese, Politikat Publike dhe Administrimi, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, dhe Integrimi Evropian) nga të cilat 2 janë të detyrueshme dhe secila përmban lëndë bazë. Format e mësimdhënies përbëjnë një praktikë të njohur ndërkombëtare dhe përfshijnë orë të planifikuara në auditor, punë në grup dhe punë kërkimore individuale. Silabuset përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm dhe forma e vlerësimit të studentit është një shumatore e mirëpërcaktuar e disa komponentëve të aktiviteteve akademike (pjesëmarrja aktive në auditor, prezantimi në grup, punimi i eseve, dhe provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare të lëndës). Personeli akademik ka kualifikimin e përshtatshëm, me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, dhe ka kryer të paktën një cikël të studimeve në një universitet nga vendet e Bashkimit Evropian dhe zotëron gjuhën angleze.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmbledh informacionet të mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standart dhe fushë synojnë të paraqesin një situatë sa më reale, rë mënyrës se si performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (www.ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga ekspertët Dr. Gert Guri dhe Assoc. Prof. Dr. Islam Jusufi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga z. Muhamed Prezja, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumenta dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të Jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është përpjekur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit.


Më datë 25/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/162 Prot., datë 16/11/2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL nuk përcolli komentet brenda afateve të përcaktuara nga ASCAL, as përmes AMS, dhe as me shkresë zyrtare. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE “SHKENCA POLITIKE - INTEGRIMI DHE QEVERISJA”


| Standardi I.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> | <p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja” (PoSIG) ofruar nga Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me universitete të ndryshme Europiane dhe Shqiptare, është në linjë me interesat dhe synimet strategjike të zhvillimit politiko-ekonomik të Republikës të Shqipërisë. Ky program i studimit është në përputhje me politikën kombëtare të avancimit të procesit të integrimit evropian dhe bashkëpunimit rajonal, si dhe qeverisjes së mirë (<i>Ref. RVB, fq. 4; Dok. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020</i>).</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> | <p>Programi i studimit PoSIG është në linjë me avancimin e vlerave akademike pasi programi i studimit trajton tema specifike të teorisë politike, politika krahasuese, politika dhe administrata publike, marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe integrimi evropian, si dhe avancimin në njohjen e metodologjive të ndryshme në shkencave sociale, e cila është e kërkuar në Shqipëri për përmirësimin e performancës akademike kombëtare (<i>Ref. RVB, 4; Dok. Ligj nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i>).</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit të Tiranës, pasi Universiteti ka qenë një nga ndër më të hershmet që ka ofruar programe në fushat e shkencave politike në vend (<i>Ref. RVB, fq. 4; Dok. Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018</i>).</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose</p> | <p>Ky program studimi, pajis studentët me aftësi të mira teorike dhe praktike, i zhvillon njohuritë e gjuhës angleze, dhe krijon mundësinë e studimit për të paktën 1 vitë në një vend evropian. Njëkohësisht, programi ofron mundësi që studentët të zhvillojnë</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| kombëtar. | hulumtim dhe kërkim shkencor që në shumë situata bëhen në tema që kanë lidhje direkte me zhvillimin politik dhe ekonomik kombëtar (Ref. RVB, fq. 4; Dok. Plani mesimor i programit të studimit; Dok. Programet mesimore të lendeve). | | |
| Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Programi PoSIG garanton formimin dhe aftësimin e studentit për kërkimin shkencor pasi në përbërje të kurrikulës ofron një trajnim gjithëpërfshirës të metodave të kërkimit shkencor në shkencat politike duke ofruar 2 lëndë të detyruara të metodave të kërkimit shkencor bazë si dhe një lëndë në metodat e kërkimit të avancuar ose atë aplikativ, si dhe një lëndë për punimi dhe mbrojtja e tezë master e cila zë 1/4 e gjithë programit të studimit (30 ECTS nga 120 ECTS të gjithë programit). Ky program studimi ofron një trajnim gjithëpërfshirës të metodave, teknikave dhe instrumentave të kërkimit shkencor në shkencat politike si dhe seminare të specializuara të metodave të hulumtimit, e cila mundëson përvetësimin e kompetencave dhe aftësive shkencore për vazhdimësinë e studimeve të thelluara në ciklin e tretë të studimeve (Ref. RVB, fq. 4-5; Dok. 4.1 - Plani mesimor i programit të studimit). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi I.2 | |
| Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe zbatim të startegjisë për zhvillimin institucional ‘Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023’. Ofrimi i programeve të përbashkëta studimi në bashkëpunim me universitete brenda dhe jashtë vendit është një nga prioritetet kryesore të planit strategjik 2018-2023 të IAL-së (prioriteti për ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, objektivat 2.1.3, 2.1.4, 2.1.5, 2.1.6) (Ref. RVB, fq. 5; Dok. 1.4 - Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023; Dok. 2.3 - Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023). |
| Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në | Programi i studimit ofrohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e përgjithshme të IAL-së. Gjithashtu, programi i studimit PoSIG, rregullohet nga një marrëveshje ndërinstitucionale me Universitetet partnere “Marrëveshje për |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| <p>përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> | <p>Programin e Masterit të Përbashkët në Shkencat Politike – Integrimi dhe Qeverisja (PoSIG)” e cila është nënshkruar më 8-12 Maj 2016 në Ljubljana, nga Bordi i koordinatorëve të programit, përfshirë edhe Universitetin e Tiranës. Kjo marrëveshje përcakton rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e programit të studimit, përfshi edhe Kurrikulën, kriteret dhe procedurën për aplikimin, përzgjedhjen dhe regjistrimin e studentëve, mënyrën e mësimdhënies dhe vlerësimit, sigurimin e cilësisë, shërbimet studentore, diplomën dhe suplementin etj. (Ref. RVB, fq. 5; Dok. 1.2 - Statuti i UT, 2018, Neni 100; Dok. 1.3 - Rregullore e UT, 2016; Dok. Marrëveshje për Programin e Masterit të Përbashkët në Shkencat Politike – Integrimi dhe Qeverisja (PoSIG), 2016).</p> | | |
| <p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p> | <p>Programi PoSIG është i përshtatshëm për fushat dhe drejtimit akademike të institucionit pasi Universiteti i Tiranës për më shumë se dy dekada ofron programe të studimit në fushat e shkencave politike. Programi gjithashtu si nga forma ashtu edhe nga shtrirja kohore është në përputhje me rregullat e institucionit. Ky program studimi ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (4 semestra) dhe emërtimi i tij është i përshtatshëm për fushat e shkencave politike. Ky program studimi është në përputhje dhe vazhdimësi me një nga fushat e drejtimit akademik të institucionit, atë të shkencave politike ku IAL-ja ofron programe studimi në nivel bachelor dhe master. Prandaj, studentëve me diplomë bachelor në shkenca politike nga Universiteti i Tiranës, ofrohet mundësija për zhvillimin e mëtejshëm e kompetencave dhe ekspertizën në fushën e integritit dhe qeverisjes, si një profil të avancuar në fushën e shkencave politike (Ref. RVB, fq. 5; Dok. 1.2 - Statuti i UT, 2018, Neni 92-94).</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p> | <p>Programi i studimit PoSIG është rezultat i bashkëpunimit me institucionet partnere në kuadër të programit evropian Erasmus+ dhe si i tillë është në përputhje me prioritetet kombëtare për ndërkombëtarizimin e institucioneve shqiptare të arsimit të lartë dhe programet e studimit duke përfshirë në fushën e Shkencave Politike, si dhe përvetësimin e praktikave të mira Evropiane për kombinimin e programeve të studimit në vende të ndryshme evropiane (Ref. RVB, fq. 6; Dok. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

standardit

X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret

Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.

Vlerësimi i ekspertëve

Objektivat në aspektin e formimit dhe punësimit të studentëve, si dhe rezultatet e të nxënësve janë përcaktuar të Marrëveshje Ndërinstitucionale me Universitetet Partnere. Ky program studimi synon të pajisë studentët i) me aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e shkencave politike, më specifiku: njohuri gjithëpërfshirëse mbi teorinë në shkencat politike, konceptet politike, aktorët, institucionet, proceset, normat dhe fushat kryesore të politikave; aftësi për të kuptuar, vlerësuar dhe aplikuar kërkimin në shkencat shoqërore me standarde të larta metodologjike; aftësinë për të analizuar problemet politike dhe shoqërore, bazuar në konceptet dhe teorinë e shkencave sociale; ii) me njohuri të thelluara metodologjike, si aftësi dhe njohuri për të aplikua në mënyrë kritike instrumentet metodologjike të kërkimit empirik dhe analitik të analizës politike, duke përfshirë aftësinë për të përdorur programet statistikore dhe për të planifikuar dhe kryer hulumtime të pavarura; aftësia për të bashkëpunuar me të tjerët, në mënyrë ndër-disiplinore), për të kryer hulumtime në grup; aftësi për të prezantuar bindshëm përpara një audience gjetjet e një hulumtimi kompleks; iii) kompetenca për një arsyetim dhe gjykim të shëndoshë, veçnisht: aftësia për të kuptuar literaturën e shkencave shoqërore dhe politike dhe për ta analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike duke u bazuar në njohuritë e disiplinave të tjera (drejtësia, ekonomia, sociologjia, historia); aftësia për të vlerësuar prezantimin e rezultateve shkencore të hulumtimit, për të bërë krahasime dhe për të dhënë mendime reflektuese; aftësia për të debatuar dhe krahasuar pikpamjet dhe pozicionet e veta me ato të të tjerëve, dhe nëse është e nevojshme për t'i azhurnuar dhe modifikuar ato; iv) kompetenca për veprime të përgjegjshme, si aftësia për të kuptuar problemet politike dhe sociale, për të zhvilluar strategji praktike për zgjidhjen si dhe prezantimin e tyre në debate publike; aftësi për të ndërlidhur shkencën me praktikën politike; aftësi për t'u përfshirë në politikë në mënyrë efektive në bazë të njohurive shkencore. Programi i studimit kombinon

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|---|---|
| | <p>teorinë me praktikën dhe hulumtimin që u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushat që zgjedhin për karrier pas përfundimit të programit (Ref. RVB, fq. 6-7; Dok. Marrëveshje për Programin e Masterit të Përbashkët në Shkencat Politike – Integrimi dhe Qeverisja - PoSIG).</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>Institucioni referohet disa dokumentave dhe studimeve të punësimin në nivel të përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale, por IAL-it i mungon studim i tregut të punës me fokus të veçantë në programin e studimit PoSIG, ndikimi i saj në tregun Shqiptar i punës, risit që ai sjell tregut shqiptar për të rritur konkurrueshmërinë në vend, arsyet e hapjes së programit, të dhëna nga komunikimi me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, dhe të dhëna mbi punësimin real të studentëve. Në mungesë të studimit të tregut të punës me fokus të veçantë në programin e studimit PoSIG, do të ishte e mirë nëse do të kishte një vlerësim nga ana e IAL për mundësitë reale në tregun e punës të programit të studimit PoSIG (Ref. RVB, fq. 7; Dok. EuroFund 2017, Labour Market Observatory 2015, European Parliament's Committee on Employment and Social Affairs 2015, The Hague Centre for Strategic Studies 2013, LSE's European Institute 2004).</p> |
| <p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> | <p>Programi i studimit PoSIG është në përputhje me kërkesat e tregut të punës pasi pajis studentët me aftësi të mira teorike dhe praktike, i zhvillon njohuritë e gjuhës angleze, i krijon mundësinë e studimit për të paktën një semestër në një vend evropian, është program i njohur dhe diplomë e përbashkët e lëshuar nga disa universitete evropiane dhe ato të shteteve të rajonit. Programi i studimit kontribuon në përgatitjen e specialistëve të aftë në qeverisjen dhe politikat specifike rajonale, dhe për të njohur me kompetencë mënyrën e funksionimit të Bashkimit Europian, duke i shërbyer kërkesave të tregut për specializime në aspektet më të rëndësishme politikëbërëse por edhe sfidave të integritit evropian. Nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, u përmend se studentët e diplomuar nga ky program studimi kanë mundur të gjejnë punë në sektorë të ndryshëm, në sektorin publik dhe privat, duke përfshirë edhe mediat (Ref. RVB, fq. 7; Dok. Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Takimet me studentët e programit dhe me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit për afrohet me programe studimi të</p> | <p>Programi i studimi është harrtuar dhe ofrohet në bashkëpunim</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| <p>ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> | <p>me disa universitete të tjera nga Evropa dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor. Ky program studimi është i përbashkët dhe bazohet në standardet Evropiane të mësimdhënies së shkencave politike në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, çka mundëson transferimin e studimeve apo punësimit e studentëve në tregun ndërkombëtar, sidomos në vendet e universiteteve partnere të përfshira. Studimi në këtë program rezulton me diplomë e përbashkët e lëshuar nga disa universitete evropiane dhe ato të shteteve të rajonit, përfshirë edhe nga Universiteti i Tiranës (Ref. RVB, fq. 7; Dok. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit).</p> |
| <p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p> | <p>Programi i studimit është hartuar në kuadër të një projekti të financuar nga Bashkimi Europian, duke përmbushur objektivat e përcaktuara nga direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Ky program studimi mbështetet në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të disa universiteteve partnere evropiane dhe nga rajoni (Ref. RVB, fq. 7-8; Dok. Projekti Erasmus+ KA2 për Ngritjen e Kapaciteteve, Projekti 561485-2015-2017, Curriculum Development joint European Political Science MA (euroPS)).</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p> | <p>Programi i studimit parashikon praktikë profesionale të detyrueshme, me ngarkesë javore 4-orë në javë (6 ECTS), me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme dhe mund të kryet në një ose maksimumi dy institucione. Për njohjen e praktikës studenti udhëhiqet nga një pedagog mbikëqyrës dhe në fund dorëzon edhe një raport mbi përvojën e punës, relevancën dhe dobishmërinë për qëllimet akademike. IAL-ja mbështet studentin, duke ofruar një listë institucionesh potenciale partnere. Nga bisedat e zhvilluara me studentët gjatë vizitës në institucion, u përmend se studentët e programit kanë kryer praktika në Austri si dhe në Shqipëri në institucione të njohura publike apo private (Ref. RVB, fq. 8; Dok. Plani mesimor i programit të studimit; Takimi me studentët e programit).</p> |
| <p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p> | <p>Gjithë programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze. Të gjithë studentët ndjekin studimet e vitit të parë në Universitetin e Salsburgut ose në atë të Ljubljajnës, dhe në vitin e dytë në një nga Universitetet partnere të Ballkanit Perëndimor. Edhe lëndët zhvilluara në Universitetin e Tiranës, ofrohen në gjuhën angleze (Ref. RVB, fq. 8; Dok. 4.1 - Plani mesimor i programit të studimit).</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al




| | | | |
|--|--|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p> | <p>I gjithë dokumentacioni përgatitet dhe ruhet në gjuhën angleze, si nga Universiteti - koordinatori kryesor i këtij programi studimi; ashtu edhe nga Universiteti e Tiranës. Institucioni përdor gjithashtu mjete të ndryshme komunikimi për menaxhimin e dokumentacionit, duke përfshirë Moodle (Ref. RVB, fq. 8; Dok. 3.18 - Raport për veprimtarinë e programit të studimit).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |


| <p>Standardi I.4 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p> | |
|--|--|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> | <p>IAL-ja ka një përvojë prej më shumë se dy dekada në fushën e studimit të shkencave politike me programe studimi në nivel Bachelor dhe Master. IAL përfshin staf akademik, studiuesve dhe personaliteteve të kualifikuara dhe me përvojë dhe që janë të dokumentuara mirë për ekspertizën e tyre nëpërmjet publikimeve të tyre në fushën e studimit të shkencave politike. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, 6 staf akademik me kohë të plotë, janë të përshtatshëm dhe kualifikuar. Gjithashtu, angazhimi edhe i pedagogëve nga universiteti i Salzburgut dhe ai i Lubljanës, është një vlerë e shtuar për këtë program studimi (Ref. RVB, fq. 9; Dok. 4.8 - Cv e personelit akademik dhe ndihmës akademik; Takimi me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe punën kërkimore të njësisë kryesore - Fakultetit të Shkencave Sociale. Fakulteti është organizuar në pesë departamente, atë të Shkencave Politike, Psikologjia, Filozofia, Sociologjia, dhe Puna Sociale. Njësisë kryesore – Fakultetit, i mungon një qëndër për kërkime shkencore (Ref. RVB, fq. 9; Dok. 2.4 - Rregullore e FSHS).</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas</p> | <p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë – Departamenti i Shkencave Politike, i cili është përgjegjës për programin e studimit. Ky departament ofron programe të ngjashme bachelor dhe master në shkenca</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | politike. Departamentet nga universitetet partnere gjithashtu kanë një lidhje të madhe me programin e studimit (Ref. RVB, fq. 9-10). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi I.5 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisve në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të përbashkët të studimit është e përcaktuar në Marrëveshjen e Universiteteve Partnere. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisve brenda institucionit përcaktohet në Statut dhe rregulloret e tjera të brendshme të institucionit. Gjithsesi, për një mbarëvajtje sa më të mirë të programit dhe për të siguruar një harmoni midis marrëveshjeve të programit me Universitetet partnere dhe akteve të brendshme të funksionimit të IAL-së, mungon një rregullore specifike të Fakultetit ose të Departamentit për programin e studimit PoSIG (Ref. RVB, fq. 10; Dok. 1.2 - Statuti i UT, 2018; Dok. 1.3 - Rregullore e UT, 2016; Dok. Marrëveshje për Programin e Masterit të Përbashkët në Shkencat Politike – Integrimi dhe Qeverisja (PoSIG), 2016). |
| Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. | PoSIG është një programi studimi i përbashkët në bashkëpunim me institucione të tjera partnere nga vendi dhe evropa. Universitetet partnere nga Austria, Sllovenia, Bosna dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut (Ref. RVB, fq. 10; Dok. Marrëveshje për Programin e Masterit të Përbashkët në Shkencat Politike – Integrimi dhe Qeverisja (PoSIG), 2016). |
| Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Specifikisht për programin e studimit, programi i studimit ka një bazë me të dhëna të palëve të treta të interesuara. Gjithashtu IAL-i ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh të bashkëpunimit në funksion të realizimit të praktikave (Ref. RVB, fq. 10-11; Dok. 2.23 - Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin). |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p> | <p>IAL-i ka nënshkruar disa marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, dhe kompani nga Shqipëria apo ndërkombëtare, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale apo stazhit. Në këtë drejtim, marrëveshjet e programit të studimit me institucionet në Austri në veçanti i kanë ndihmuar studentët që të gjejnë lehtësisht institucione për kryerjen e praktikës së tyre (Ref. RVB, fq. 11; Dok. Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin; Dok. 4.6 - Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit;).</p> | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p> | <p>IAL-ja disponon një numër marrëveshjes dhe projekte të tjera me Universitete partnere të huaja dhe vendase, si dhe ka qënë e angazhuar në një numër projektesh të tilla si Jean Monnet me qëllim kërkimin shkencor si dhe mobilitetin e personelit dhe studentëve (Ref. RVB, fq. 11; Dok. 4.6 - Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Takimi me GVB).</p> | | |
| <p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p> | <p>Vlerësimet i bashkëpunimit dhe angazhimit të palëve të interesit, janë kryer në përfundim të projekteve të bashkëpunimit si dhe në raportet vjetore të Fakultetit dhe të Departamentit. Por, mungon raporte të përditësuara analitike të përfitimeve dhe sfidat nga bashkëpunimet me universitetet partnere në funksion të realizimit të programit të studimit PoSIG (Ref. RVB, fq. 12).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | X | |


| <p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p> | |
|--|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>IAL-ja ka hartuar Planin Strategjik të kërkimit shkencor të UT-së (2018-2023), i cili detajon objektivat dhe instrumentat për të përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor. Në strategjinë e tij, IAL-ja synon të rrit mundësitë e kërkimit shkencor nga stafi akademik. Gjithashtu, IAL-ja ka përgatitur Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT. Ndikimi i Udhëzuesit ende është për t'u parë. Aktiviteti kërkimor mbështetet si nga burimet e brendshme të institucionit ashtu edhe nga donacionet dhe financimet nga jashtë nëpërmjet projekteve të ndryshme</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|---|
| | kombëtare dhe ndërkombëtare (Ref. RVB, fq. 12; Dok. 1.16 - Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë). |
| Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Te Fakulteti është i përcaktuar pozicioni i Zv. Dekanit për Kërkimin Shkencor, i cili mbulon pjesën e kërkimit shkencor. IAL-ja posedon zyrën e projekteve që është përgjegjëse për financimin e zgjerimit të kërkimit shkencor. Por, njësi përkatese i mungojnë instrumente dhe kapacitete për të vlerësuar rezultatet e hulumtimit (Ref. RVB, fq. 12; Dok. Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Takim me Zv. Dekanin për Kërkimin Shkencor; Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë). |
| Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Universiteti u mundëson pedagogëve pjesëmarrjen për të referuar në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, nëpërmjet Udhëzuesit për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor institucioni nxiton stafin që të botojë rezultatet nga kërkimit shkencor. Departamenti u ofron pedagogëve mundësinë për të publikuar në revistën e saj shkencore Politikja. Por, lidhja e publikimeve akademike të personelit vetëm me kërkesat për avancim të stafit në titujt e tyre akademikë, nuk mjafton për promovimin e kulturës akademike të kërkimit shkencor tek anëtarët e stafit akademik. Nga CV-të e bashkangjitura me RVB shihet se stafi akademik ka publikuar shumë pak në pesë vitet e fundit (Ref. RVB, fq. 13; Dok. 1.16 - Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Dok. 4.8 - Cv e personelit akademik dhe ndihmesakademik). |
| Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. | IAL-ja ka të parashikuar në Kodin e Etikës së institucionit parimet, vlerat, si dhe praktikat e mira që duhet të ndjekë çdo anëtar i personelit akademik apo student, në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, veprimtarinë kërkimore e botuese. IAL-ja synon arritjen e standarteve më të larta të integritetit, të ndershmerisë morale dhe të përgjegjësisë, duke përdor edhe sistemet të antiplagjiaturës Turnitin, e cila ndihmon për të kontrolluar punimet e studentëve. Kodi i Etikës parashikon edhe masat disiplinore për shkeljet disiplinore të anëtarit të personelit (Ref. RVB, fq. 13; Dok. 1.5 - Kodi i Etikës). |
| Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor | Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor duke i nxitur të botojnë punimet e tyre në revistën shkencore |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | Politikja, ose të referojnë në konferencat kombërate dhe ndërkombëtare (Ref. RVB, fq. 13). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | | | |
|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE


| | |
|---|---|
| Standardi II.1 | |
| Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite (ECTS), të shtrira në 4 semestra me 30 ECTS për çdo semester. Programi përmban: 2 module të detyrueshme me zgjedhje nga 5 (Modulet e detyrueshme: Teoritë politike; Politika e Krahasuar; Administrata publike; Marrëdhënie ndërkombëtare; Integrimi Evropian (me 18 ECTS secila); 4 kurse të detyrueshme (Kursi i metodave I dhe II, Seminaret për punimin e diplomës, si dhe praktika, 6 ECTS secila); 1 Kurse të detyrueshme me zgjedhje (nga 2 të ofruarave Metoda të avancuara në Shkenca Politike; Kurse të aplikuar – 6 ECTS secila); 4 kurse shtesë (6 ECTS secila); dhe Punimi i diplomës (30 ECTS). Organizimi është në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për programet master të shkencave dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (Ref. RVB, fq. 13-14; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit). |
| Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh. | Programi i studimit me ofrimin e 5 moduleve me zgjedhje mbulon më së miri drejtimit kryesorë të disiplinës së shkencave politike, që nga teoria politike, politika e krahasuar, politikat publike dhe administrimi publik, deri tek marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimin evropian. Gjithashtu struktura e |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| | <p>programit të studimit ofron njohuri bazë dhe të thelluara për secilën prej profileve, si dhe trajtime të specializuara dhe empirike të çështjeve specifike që lidhen me rajonin. Në përfundim të programit të studimit, studenti mund të ushtrojë një llojshmëri profesionale dhe specialitetesh si nëpunës i administratës publike dhe shërbimeve diplomatike, punonjës në organizata ndërkombëtare dhe jo qeveritare, ekspert në institucionet e Bashkimit Europian, fondacione, akademi, institute të edukimit dhe arsimore, kompanitë fitimprurëse ose organizata biznesi, media, si dhe vazhdimin e një karriere akademike si lektor ose kërkues shkencor (Ref. RVB, fq. 14; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit).</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> | <p>Programi i studimit lejon specializimin e thelluar të studentit në dy drejtime kryesore të shkencave politike, duke ndërthurrur njohuritë teorike bazë, me njohuritë specifike dhe me metodat e kërkimit, madje në një raport pothuajse të barabartë. Studentët zgjedhin dy module për të ndjekur fushën e tyre të specializimit nga pesë modulet ekzistuese: Moduli 1: Teoria Politike; Moduli 2: Politika krahasuese; Moduli 3: Politika dhe Administrata Publike; Moduli 4: Marrëdhënie Ndërkombëtare; Moduli 5: Integrimi Evropian. Programi ofron njohuri të thelluara metodologjike, si aftësi dhe njohuri për të aplikua në mënyrë kritike instrumentet metodologjike të kërkimit empirik dhe analitik të analizës politike, duke përfshirë aftësinë për të përdorur programet statistikore dhe për të planifikuar dhe kryer hulumtime të pavarura. Nga takimi me studentët e programit, vumë re se studentët kanë marrë njohuritë e nevojshme dhe kanë aftësi për t'i parë me sy kritik zhvillimet (Ref. RVB, fq. 14; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 3.18 - Raport për veprimtarinë e programit të studimit; Takim me studentët e programit të studimit).</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i studimit ofron kompetenca për një arsyetim dhe gjykim të shëndoshë, duke zhvilluar aftësinë për të analizuar dhe vlerësuar probleme komplekse politike dhe shoqërore, bazuar në konceptet dhe teoritë e shkencave sociale, aftësinë për të vlerësuar rezultate shkencore, për të bërë krahasime dhe për të dhënë mendime reflektuese. Kurset e vitit të dytë në universitetet partnere, siç është edhe Universiteti i Tiranës, u mundësojnë studentëve të specializohen në një fushë dhe të zbatohet e njëjta në rrethanat shqiptare (Ref. RVB, fq. 14; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 3.18 - Raport për veprimtarinë e programit të studimit; Takim me studentët e</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> | <p><i>programit të studimit).</i></p> <p>Programi i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, si rregulloren me objektivat formuese, kompetencat profesionale, kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; planin mësimor me kategoritë e veprimtarive formuese të shprehura në kreditet ECTS; programin lëndor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; diplomën dhe suplementin. Ky është një program i përbashkët studimi, dhe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, Neni 80, dhe procesi i realizimit të programit kryhet në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit ku mund të zbatohen edhe standarde të ndryshme ndërkombëtare nga ato shtetërore. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse (<i>Ref. RVB, fq. 14; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. Ligj nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i>).</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Programi i studimit ka përcaktuar kategoritë e veprimtarive formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe grupohen në kategori të lëndë bazë dhe karakterizuese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, këto veprimtari formuese janë të detyrueshme dhe disa ofrohen me zgjedhje nga vetë studentët ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni. Pësha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, është e ndryshme. 36 ECTS i takojnë grup-lëndëve në 2 prej 5 nën-degëve të shkencave politike, 24 ECTS + 6 ECTS i takojnë metodave të kërkimit shkencor bazë, atij të avancuar dhe të aplikuar, si dhe praktikës profesionale, 24 ECTS janë lëndë me zgjedhje për tematika që i takojnë rajonit të Ballkanit Perëndimor, dhe 30 ECTS përgatitja dhe mbrojtja e tezës së diplomës. Kjo ndarje e ngarkesës është relativisht e përshtatshme për këtë program studimi, ndonëse vërehet një theks i veçantë në aspektet e metodologjisë dhe metodikës së kërkimit shkencor (1/5 e programit të studimit). Gjithashtu, <i>përqindja totale e lëndëve sipas tipit të komponentit mësimor nuk është sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë</i>, por meqënëse ky është një program i përbashkët studimi, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, Neni 80, mund të aplikohen standarde të tjera të ngarkesës në kredite (dhe për rrjedhojë përqindjet) sipas komponentëve mësimorë, përcaktuar në marrëveshjen e</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>bashkëpunimit. Lëndë Bazë (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme) përbëjnë 24 ECTS (20%), Lëndë Karakterizuese (përgatitje për disiplinën shkencore) përbëjnë 24 ECTS (20%), Lëndë Ndërdisciplonore Integruese (nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje) përbëjnë 36 ECTS (30%), Lëndë Plotësues (praktika profesionale) përbën 6 ECTS (5%) dhe Detyrime Përmbyllëse, Tema e Diplomës përbën 30 ECTS (25%). <i>Megjithatë, do të ishte e dobishme që Zyra e Kurrikulave të prodhojë analizë ose opinionë si balanca ndërmjet kategorive të përcaktuara në kredite është në përputhje me legjislacionin kombëtar (Ref. RVB, fq. 15; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. Ligj nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; Dok. VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë; Takim me Zyrën e Kurrikulave).</i></p> | | |
| <p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p> | <p>Programi i studimit ka përcaktuar 30 ECTS për realizimin e diplomës, si dhe 6 ECTS janë dedikuar seminareve metodologjike për punimin e diplomës, me qëllim për të ndihmuar studentët në zhvillimin e saj. Punimi i diplomës është një projekt kërkimor individual, i cili monitorohet nga dy supervisor të specializuar në fushën përkatëse të specializimit të studentit. Tema e punimit të diplomës duhet të lidhet me një nga dy modulet e detyrueshme të ndjekura nga student (Ref. RVB, fq. 15; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> |


| | |
|--|--|
| <p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>IAL-ja është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018. Njësia kryesore – Fakulteti i Shkencave Sociale dhe njësia bazë – Departamenti i shkencave politike përgjegjës për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin (Ref. RVB, fq. 15; Dok. 1.2 - Statuti i UT, 2018; Dok. 1.3 - Rregullore e UT, 2016; Dok. 2.4 - Rregullore e FSHS; Dok. 3.3 - Rregullore e departamentit).</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>Fakulteti i Shkencave Sociale si njësia kryesore dhe Departamenti i Shkencave Politike si njësia bazë për programin e studimit përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti është themeluar në vitin 1992 dhe ai ka 5 Departamente dhe 76 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë. Departamenti është themeluar në vitin 2000 dhe ka çuar në diplomim disa qindra studentëve në fushën e shkencave politike. Aktualisht, Departamenti ka një nga studentët aktivë më të lartë në vend që studion për shkencat politike. Departamenti gjithsej ofron 4 programe studimi: 1 në nivel Bachelor dhe 3 në nivel Master (Ref. RVB, fq. 15-16; Dok. 2.4 - Rregullore e FSHS; Dok. 3.3 - Rregullore e departamentit).</p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p> | <p>Departamenti për vitin 2020-2021 ka në përbërjen e tij 10 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë (Personel Akademik Efektiv - PAE), nga këta 2 kanë tituj akademik (Prof.As.), dhe 8 janë me grada shkencore (Dr). Gjithashtu edhe 39 personale me kohë të pjesshme (Personel Akademik me Kontratë - PAK), nga këta 5 kanë tituj akademik (2 Prof. Dr, 3 Prof.As.), 15 janë me grada shkencore (Dr), 4 janë në proces të fitimit të gradës shkencore (Dr) dhe 15 janë në nivelin Master i Shkencave (Msc). Si njësia kryesore dhe ajo bazë ku ofrohet programi i studimit përbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (Ref. RVB, fq. 16; Dok. 4.3 - Të dhëna tabelore për personelin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>Personeli akademik nga njësia kryesore dhe ajo bazë i angazhuar në këtë program studimi është gjithsej 7, i gjithi, me kohë të plotë dhe ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, personel me tituj dhe/ose grade shkencore (Ref. RVB, fq. 16; Dok. 4.3 - Të dhëna tabelore për personelin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p> | <p>Departamenti për realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve studimore e kërkimore, angazhon personel akademik ndihmës nga Fakulteti si dhe 16 staf me kohë të pjesshme nga universitete dhe institucione të tjera në vend. Departamenti për vendosjen e studentëve në praktikën profesionale, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse në vend (Ref. RVB, fq. 16; Dok. 4.3 - Të dhëna tabelore për personelin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për</p> | <p>Departamenti ka caktuar një pedagog nga departamenti si koordinator të programit të studimit PoSIG. Koordinatori është përgjegjës për menaxhimin e programit dhe bashkëpunimin me universitetet në konsorcium. Koordinatori gjithashtu vepron si</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | koordinator lokal dhe person kontaktues për studentët (<i>Ref. RVB, fq. 17; Dok. Vendim per caktimin e koordinatorit te programit te studimit; Dok. Pershkrim i detyrave te koordinatorit te programit te studimit; Takim me koordinatorin e programit</i>). | | |
| Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit | Koordinatori është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe ai raporton dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit në mënyrë periodike në takimet të rregullta të departamentit dhe te drejtuesi i departamentit (<i>Ref. RVB, fq. 17; Dok. Pershkrim i detyrave te koordinatorit te programit te studimit; Takim me koordinatorin e programit</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi II.3 | |
|---|---|
| Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësisia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Shkencave Politike kanë në dispozicion informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit PoSIG. Drejtuesi i departamentit si dhe Koordinatori përgjegjës për këtë program studimi janë pikat e kontaktit që mbajnë kontakte me Universitetin leader (Universiteti i Salzburgut) dhe universitete të tjera partnere. <i>Por, nga takimet e zhvilluara në institucion, personat përgjegjës për programin nuk zotëronin të gjitha detajet e programit, si për shembull mënyrën e regjistrimit të studentëve PoSIG në Universitetin e Tiranës (studentë me kohë të plotë ose studentë të transferuar) (Ref. RVB, fq. 17; takimet te institucioni).</i> |
| Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Programi i studimit organizohet në lëndë dhe module, praktikë dhe aktivitete formuese të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara sipas komponentëve mësimorë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (<i>Ref. RVB, fq. 17-18; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve</i>). |
| Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Kërkesat te programi i studimit PoSIG janë përcaktuar me kredite evropiane përkatëse ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System - Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive). Ky program i përbashkët studimit ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| | studimi prej 2 vitesh (60 ECTS për vit) ose 4 semestra (30 ECTS për semestër) (Ref. RVB, fq. 18; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndëve). |
| Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Plani mësimor i detajuar përfshin strukturën e programit, tipin dhe përmbajtjen e kursit, planin e studimit, rregullorja e provimit dhe mënyra e vlerësimit, përshkrimi i detajuar i lëndës, ngarkesën mësimore dhe orët në auditor ku çdo ECTS përbën 25 orë studimi (150 orë për 6 kredite), dhe në një vit akademik me 60 ECTS mesatarisht 1500 orë studimi. Në të gjitha lëndët, performanca e studentëve vlerësohet me mjete të ndryshme siç janë prania e detyrueshme në mësim, seminare, projekte, prezentime dhe provime me shkrim (Ref. RVB, fq. 18; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndëve). |
| Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit përmban informacion të detajuar për regjistrimin dhe përzgjedhjen e studentëve e cila realizohet nga Komisioni i Bordit të Kordinatorëve në bazë të vlerësimeve me pikë të kriterëve të bëra publike paraprakisht, ku përfshihet performanca akademike e studimeve të mëparshëm, letra e motivimit dhe rekomandimet, rezultatet e intervistës personale dhe niveli i gjuhës angleze. Programi i studimit përmban edhe informacion mbi mobilitetin dhe transferimin e studimeve në bazë të kartës europiane të Bolonjës. Nga dokumentacioni i siguruar dhe nga takimet e zhvilluara në institucionet e qartë se universitetet partnere, përfshirë Universitetin e Tiranës, kanë pasur prioritet regjistrimin e studentëve të tyre bachelor të diplomuar në programin e studimit PoSIG. Ka pasur vëmendje të kufizuar për të tërhequr studentë nga institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, përveç atyre që janë universitete partnere në PoSIG, siç është Universiteti Europian i Tiranës (Ref. RVB, fq. 18-19; Dok. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Dok. Raport për veprimtarinë e programit të studimit; Takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale, me Drejtuesin e Departamentit të Shkencave Politike dhe me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm). |
| Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabusët e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit | Programi i studimit përmban edhe një përshkrim të detajuar për programin lëndor për secilë lëndë, ku përfshihen objektivat specifike të lëndës, numri përkatës i orëve të leksioneve dhe seminarëve, përmbajtjen e temave, literaturën e detyrueshme dhe atë më zgjedhje, kompetencat dhe njohuritë që përfitohen |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>nga to. Për çdo lëndë janë përcaktuar temat (ato variojnë nga 13 deri 20 tema për lëndë), format e mësimdhënies dhe ngarkesa mësimore respektive në auditor dhe jashtë saj si dhe temat specifike, megjithatë raporti i të cilës varion në varësi të lëndës duke i dhënë autonomi pedagogut të lëndës. Kjo ndarje e ngarkesës në orë leksioni në auditor, punë në grup dhe punë kërkimore individuale i mundëson studentit një përgatitje të mirë si në aspektin e përgjithshme teorike dhe atë praktik të lëndës ashtu edhe në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe njohurive të thelluara në tematika dhe çështje të caktuara (Ref. RVB, fq. 19; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve).</p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit të përbashkët është rezultat i një marrëveshje ndër-institucionale dhe si e tillë ndryshimi i tij do të kërkojë diskutimin dhe aprovimin e të gjithë partnerëve. Megjithatë, rishikimi dhe përditësimi i lëndëve të ofruara është kompetenca e Departamentit të Shkencave Politike, dhe çdo silabus përditësohet, rishikohet dhe miratohet përpara fillimit të çdo semestri nga departamenti (Ref. RVB, fq. 19; Dok. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Takime me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe me stafin akademik).</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.



| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> | <p>Ngarkesa e programit të studimit është ndërtuar sipas legjislacionit evropian dhe atij shqiptar të arsimit, dhe është e përshtatshme për nivelin 7 në Kornizën kombëtare të kualifikimeve. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite. Por, nga takimi i zhvilluar me studentët, u vu re se zakonisht studentët vonojnë diplomimin edhe për një vit shtesë, për faktin se shpesh janë të punësuar (Ref. RVB, fq. 19; Dok. Plani mësimor i programit të studimit; Takim me studentët e programit të studimit).</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> | <p>Programi i studimit PoSIG ofron kompetenca teorike dhe metodologjike dhe aftësi të kërkimit shkencor në të gjitha drejtimet e shkencave politike; veçanërisht në aspekte të cilat kanë të bëjnë me njohjen, kuptimin dhe analizën e teorisë politike, politikës së krahasuar, politikave publike dhe administrimit, marrëdhëniet ndërkombëtare, ose integritin evropian. Të gjithë këta elementë ndihmojnë në zhvillimin e ekspertizës në profile specifike të shkencave politike dhe avancimit në karrierrë profesionale ose vazhdimësinë e programe studimore të mëtejshme, por edhe për tu përballur me tregun e punës. Nga takimi i zhvilluar me studentët u vu re se shumica e të diplomuarve të programit janë tashmë të punësuar në insitucione të ndryshme, si në administratën publike, media dhe sektorin privat (<i>Ref. RVB, fq. 19-20; Dok. Programet mesimore te lendeve; takim me studentët e programit të studimit</i>).</p> |
| <p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> | <p>Lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar më konkretisht në Planin Mësimor, janë ndërtuar për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Përveç lëndëve bazë (6 ECTS) të çdo prej 5 modulet e drejtimeve në shkencat politike, ofrohen edhe njohuri të thelluara (12 ECTS) në secilën prej drejtimeve duke siguruar një përgatitje të plotë (njohuri bazë dhe të thelluara në të paktën 2 drejtime kryesore të shkencave politike. Në përgjithësi ndarja e ECTS-ve sipas moduleve dhe lëndëve ka ngarkesë të barasvlefshme. <i>Kjo ndarje përse i takon moduleve është e përshtatshme, ndërsa ndarja në ngarkesë të barasvlefshme (6 ECTS) e të gjithë lëndëve duhet të jetë një aspekt për tu rishikuar, kjo edhe për ti dhënë më tepër peshë ndoshta aspekteve të lëndëve të thelluara në krahasim me lëndët bazë, duke ruajtur ngarkesën aktuale të moduleve atë të 18 ECTS.</i> Programi i studimit mundëson kompetenca të specializimit në çështje të ndryshme në fushën e shkencave politike të tilla si demokratizimi dhe evropianizimi të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në këtë mënyrë, programi i studimit ofron aftësimin për kërkim shkencor të pavarur (<i>Ref. RVB, fq. 20; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mesimore të lendeve</i>).</p> |
| <p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre,</p> | <p>Programi i studimit është hartuar në bazë të kritereve dhe</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|---|---|
| <p>ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>standarteve të ciklit të dytë të studimeve dhe në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve duke kombinuar lëndë të formimit metodologjik dhe teorik bazë, grup-lëndësh karakterizuese dhe me zgjedhje, praktikë profesionale dhe kërkim shkencor të pavarur. Ky program studimi është rezultat i bashkëpunimit si edhe në përputhje me programet të ngjashme dhe praktikat të mira ndërkombëtare që zhvillohen nëpër universitetet partnere (Ref. RVB, fq. 20; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve).</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Ndarje e ngarkesës është relativisht e përshtatshme për këtë program studimi, ndonëse vërehet një theks i veçantë në aspektet e metodologjisë dhe metodikës së kërkimit shkencor (1/5 e programit të studimit). Një nga kriteret e këtij programi studimi është kryerja e studimeve në të paktën 2 universitete (dhe maksimumi 4 universitete) ku një vit akademik (ose një semester) do të duhet të realizohet në një nga universitetet e konsorciumit nga vendet e Bashkimit Evropian dhe viti tjetër në të paktën një (maksimumi 2) nga universitetet partnere të Ballkanit Perëndimor, duke garantuar kështu lëvizshmërinë e studentëve (Ref. RVB, fq. 20-21; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve).</p> |
| <p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>Programi i studimit është në gjuhën angleze, e cila mundëson përdorimin e literaturës të detyrueshme dhe asaj të rekomanduar të përditësuar dhe nga autorët dhe shtëpi botuese akademike të njohur ndërkombëtarisht. Nga syllabuset e bashkangjitura të RVB mund të shihet se literatura e përdorur kryesisht nuk është bashkëkohore ose e 5 viteve të fundit (Ref. RVB, fq. 21; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve).</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit, e ndërtuar nga një konsorcium universitetesh partnere dhe ekspertë të fushës garanton cilësinë dhe përfitimin e dijeve dhe kompetencave të synuara në këtë program të ciklit të dytë të studimeve (Ref. RVB, fq. 21; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve).</p> |
| <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Gjithashtu, përmbajtja e programit të studimit pajisë studentët me aftësi dhe kompetanca profesionale në fushën e shkencave politike, me profilizim në fusha specifike si dhe çështje aktuale të demokratizimit dhe integritit evropian të rajonit të Ballkanit Perëndimor e cila mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>(Ref. RVB, fq. 21; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndëve; takime me studentët e programit të studimit dhe me GVB).</i> | | |
| Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Programi i studimit PoSIG është i përbashkët dhe ofrohet nga një koncertium universitar dhe për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit do të duhet miratimi i të gjithë partnerëve. <i>Megjithatë, duke pasur parasysh se nuk është bërë analizë e tregut të punës për nevojat e programit, është e këshillueshme që për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, Fakulteti dhe/ose Departamenti të analizojë dhe të përcjellë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, duke përfshirë në to mendimin e studentëve, dhe personelit akademik, për të ndërmarr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter praktik dhe kërkesat e tregut të punës (Ref. RVB, fq. 21-22; takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës).</i> | | |
| Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve | Programi i studimit ofron një trajnim gjithëpërfshirës të metodave të kërkimit shkencor në shkencat politike duke ofruar 2 lëndë të metodave të kërkimit shkencor bazë (12ECTS) si dhe një lëndë në metodat e kërkimit të avancuar ose atë aplikativ (6ECTS). Gjithashtu, ofrimi i një lëndë për teknikat dhe instrumentat e zhvillimit të një teze diplome (6ECTS) mundëson përvetësimin e kompetencave dhe aftësive për organizimin e një punimi shkencor të pavarur në tema të caktuara të shkencave politike. Programi i studimit garanton formimin dhe aftësimin e studentit për kërkimin shkencor në vijim në ciklin e tretë të studimeve. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesë në Tezën e Diplomës i aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshëm në studime të ciklit të tretë, doktoraturës <i>(Ref. RVB, fq. 22; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndëve; takime me studentët e programit të studimit dhe me stafin akademik).</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |


Standardi II.5
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.


| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> | <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit (7 pedagogë me kohë të plotë) është konform kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe deklarojnë njohuri të mira të gjuhës angleze. 100% të programit të studimit që bie në përgjegjësinë e Universitetit të Tiranës mbulohet nga personeli akademik me kohë të plotë (Ref. RVB. Fq. 22; Dok. 4.3 - Të dhëna tabelore për personelin akademik; Dok. 4.8 - Cv e personelit akademik dhe ndihmësakademik; takim me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Personeli akademik i institucionit i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimeve është 7 personel me kohë të plotë dhe ka përvojën dhe nivelin e duhur të kualifikimit akademik (3 Prof. Asoc. dhe 4 Doktor Shkencash). Gjithashtu, pjesa më e madhe e stafit aktual të angazhuar në mësimdhënie plotëson kërkesat shtesë të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit (si përfshirja në aktivitete ndërkombëtare të shkëmbimit të stafit, pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet e kërkuara të menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit të mësimdhënies EuroPS (platform eLearning, eLibrary, kontrolli i plagjiaturës etj.). 100% e ngarkesës mësimore të këtij programi studimi mbulohet nga stafi efektiv. Ngarkesa e plotë mësimore e personelit akademik të programit varion nga 90 orë në 275 orë. Nuk ka tejkalim të normës mësimore. IAL zbaton udhëzimet e MASR për sa i përket ndarjes së ngarkesës së stafit akademik (Ref. RVB, fq. 22; Dok. 4.3 - Të dhëna tabelore për personelin akademik; Dok. 4.8 - Cv e personelit akademik dhe ndihmësakademik; takim me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> | <p>Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe ajo specifike e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve që ofron gjithsecili. Ky parim është respektuar falë rregullave të programit ku ekspertiza akademike dhe kërkimore, si dhe përvoja në fushën e mësimdhënies janë kriteret për përzgjedhjen e pedagogëve në lëndët specifike që ata duhet të mbulojnë (Ref. RVB, fq. 23; Dok. 4.3 - Të dhëna tabelore për personelin akademik; Dok. 4.8 - Cv e personelit akademik dhe ndihmësakademik; takim me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera</p> | <p>Departamenti cakton një pedagog mbikqyrës për praktikën</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|---|-----------------------------|--|
| <p>të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>studentore, në rolin e këshilluesit në praktikën profesionale dhe të karrierës. Gjithashtu, programi ofron kontakte të nevojshme për studentët për qëllime të zhvillimit të praktikës dhe gjithashtu IAL-ja ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh për këtë qëllim. Në lidhje me punimin e diplomës studenti udhëhiqet nga 2 supervizorë (zakonisht 1 nga Universiteti i Salzburit dhe 1 nga Universiteti i Tiranës). të cilët kanë njohuri specifike akademike në fushën ku studenti zhvillon temën. Mentorimi kryet që nga faza e ideimit të punimit të diplomës e deri te përfundimi dhe mbrojtja e saj (Ref. RVB, fq. 23; Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2 - Programet mësimore të lëndeve; Dok. "Marrëveshje për Programin e Masterit të Përbashkët në Shkencat Politike – Integrimi dhe Qeverisja (PoSIG)"; takime me studentët e programit të studimit dhe me GVB).</p> | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>Ky program studimi nuk parashikon orë laboratorike. Në nivel Fakulteti IAL-ja ka zyra përgjegjëse, të cilat merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mbarëvajtjen e laboratorëve teknologjikë dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore. Departamenti për realizimin e praktikave mësimore, projekteve studimore e kërkimore, angazhon personel akademik ndihmës nga Fakulteti si dhe 16 staf me kohë të pjeshme nga universitete dhe institucione të tjera në vend (Ref. RVB, fq. 23; takim me GVB).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |


| | |
|--|---|
| <p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <p>Ashtu sikurse është thënë edhe më sipër, programi i studimit është i përbashkët dhe ofrohet nga një koncertium universitar dhe për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit do të duhet miratimi i të gjithë partnerëve. <i>Megjithatë, duke pasur parasysh se nuk është bërë analizë e tregut të punës për nevojat e programit të studimit, është e këshillueshme që për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, Fakulteti dhe/ose Departamenti të analizojë dhe të përcjellë propozimet</i></p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| | <i>e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, duke përfshirë në to mendimin e studentëve, personelit akademik, dhe të dhe palëve të tjera të interesuara, për të ndërmarr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter praktik dhe kërkesat e tregut të punës (Ref. RVB, fq. 24; takim me GVB).</i> |
| Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | IAL-ja synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit si dhe sigurimin e përfshirjes së studentëve në bordet përkatëse të institucionit dhe në aktivitetet e departamenteve, punën kërkimor-shkencor, botimet akademike dhe revistat shkencore, konferencat dhe workshopet. Gjithashtu, studentët kanë mundësinë të japin opinionet e tyre nëpërmjet anketave të kryera në fund të çdo semestri. Por, nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, u vu re mungesa e studentëve në takimet përkatëse si takimi me grupin e brendshëm të vlerësimit apo takimi me organet e sigurimit të cilësisë (Ref. RVB, fq. 24; Dok. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Dok. Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise së Sigurimit të Cilësisë; Dok. Përshkrim i veprimtarisë së Njesise së Sigurimit të Cilësisë; Dok. Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS; Dok. Politika e sigurimit të cilësisë FSHS; Dok. Te dhena tabelore për njesinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS; takime të institucionit). |
| Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | Mendimet e studentëve Alumni për përmirësimin e programeve apo futjen e lëndëve të reja në programe të caktuara sigurohen nga Zyra e Karrierës ose nëpërmjet kontakteve periodike të stafit të Departamentit me studentët e diplomuar (Ref. RVB, fq. 24; Dok. 3.3 - Rregullore e departamentit; Dok. 2.26 - Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative; takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës). |
| Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi | Për programin e studimit të përbashkët, IAL bashkëpunon me Universitetet partnere në rast përditësimi, përshtatje dhe riorganizimi për fushat e posaçme të studimit dhe kërkimit. Universiteti dhe Fakulteti kanë nënshkruar një sërë marrëveshjesh me universitetet e vendeve të BE-së dhe jashtë BE-së për rritjen e kapaciteteve kërkimore. Marrëveshja që ka çuar në krijimin e programit PoSIG është një praktikë më e mirë në këtë drejtim (Ref. RVB, fq. 25; Dok. Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin; takim me Degën e |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | <i>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës).</i> | | |
|-------------------------------------|---|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi II.7 | |
|---|--|
| Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p> | <p>Programi i studimit PoSIG ka si prioritet kryesor ofrimin e një diplomë të përbashkët dhe ndërkombëtare në shkencat politike në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e studimeve shoqërore-politike, me ndikim në rajon e më gjerë, duke ju ofruar një edukim cilësor në partneritet me institucione ndërkombëtare. Programi i studimit ofron pesë module, nga të cilat studentët zgjedhin dy për të ndjekur fushën e tyre të specializimit. Çdo modul ofron kurse specifike. Studentët mund të shprehin preferencat e tyre për universitetet e BE-së për Vitin 1 për çdo semestër dhe më pas preferencat e tyre të përkohshme për një nga Universitetet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2 për çdo semestër. Studentët referohen kurseve specifike të ofruara në çdo universitet partner, përpara se të bëjnë zgjedhjen e përkohshme të opsioneve të lëvizshmërisë për vitin 2 (<i>Ref. RVB, fq. 25; Dok. Udhezues per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor ne UT; Dok. Te dhena per aktivitet per kualifikimin per kerkim shkencor te personelin akademik per 5 vitet e fundit</i>).</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> | <p>Programi i studimit administrohet nga bordi i kordinatorëve të universiteteve partnere, i cili në bashkëpunim me njësitë bazë të IAL-së, garantojnë dhe mundësojnë liritë akademike të personelit, duke u bazuar në parimet dhe praktikat më të mira të arsimit evropian. Programi i studimit bazohet në standardet dhe standardet ndërkombëtare të mësimdhënies së shkencave politike në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Universitetet partnere kontribuojnë me profilet e tyre specifike akademike. Partnerët e Ballkanit Perëndimor ofrojnë gjithashtu kompetenca specifike akademike në lidhje me zhvillimet politike në rajon (<i>Ref. RVB, fq. 25; Dok. Plani mesimor i programit te studimit; Dok. Programet mesimore te lendeve</i>).</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe</p> | <p>Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore në</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| aktivitete kërkimore. | bashkëpunim me pedagogët e tyre, angazhimit të studentëve në aktivitetin shkencor të detyruar të programit, si punimi i diplomës apo detyrave të kursit (Ref. RVB, fq. 25-26; Dok. Politika për mbështetjen e studenteve dhe strukturat e tyre organizative; takime me stafin akademik dhe me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës). | | |
| Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | Programi i studimit është rezultat i bashkëpunimit me universitete evropiane dhe rajonale dhe zbatimit të politikave studimore dhe shkencore evropiane. PoSIG është një program i përbashkët master dyvjeçar (120 ECTS) që mbulon të gjitha fushat e Shkencave Politike. PoSIG si kurrikulë ofrohet nga nëntë universitete partnere nga Austria, Sllovenia, Bosina dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Diploma e përbashkët PoSIG jepet nga të gjitha universitetet nga konsorciumi që një student ka ndjekur gjatë studimeve dyvjeçare për të paktën një mandat akademik (Ref. RVB, fq. 26; Dok. Plani mesimor i programit të studimit; takim me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale). | | |
| Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | Në nivel institucional kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet fondit institucional për aktivitete kërkimore. Staf i akademik inkurajohet gjithashtu të aplikojë për programe financimi kombëtare dhe ndërkombëtare për të zbatuar aktivitete kërkimore. Kërkimi akademik financohet kryesisht nga financues të jashtëm. Ndërsa skema e brendshme e financimit të bazuar në universitet është në fazën e zhvillimit (Ref. RVB, fq. 26; Dok. 1.16 - Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi II.8 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron | IAL mundëson një mjedis motivues të kërkimit shkencor për personelin akademik dhe studentët, dhe stafi akademik nëpërmjet zyrës së projekteve bashkëpunon me institucione |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | partnere në projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Programet përkatëse në të cilat është bërë pjesë Universiteti përfshijnë: Erasmus +, Horizon 2020, Tempus, etj. (Ref. RVB, fq. 26-27; Dok. 1.16 - Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë). | | | |
| Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | IAL-ja ofron stafit akademik mundësi dhe mbështetje për veprimtari kërkimore shkencore, projekte dhe analiza studimore. Risi janë Udhëzimet e reja e IAL për mbështetjen financiare të hulumtimit nga stafi akademik. Departamenti është partner në disa projekte kërkimore siç është programi Jean Monnet. Por, përfshirja e studentëve në studime shkencore është e ulët (Ref. RVB, fq. 27; Dok. 4.6 - Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Dok. 1.16 - Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë). | | | |
| Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave | Fakulteti dhe Departamenti organizon konferenca dhe aktivitete si dhe boton revistën akademike 'Politikja'. Por, këta hapësira deri më tani nuk janë përdorur për qëllime specifike të programit të studimit PoSIG (Ref. RVB, fq. 27; Takim me stafin akademik). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|---|
| Standardi III.1 | |
| Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave | Në nivel institucional IAL-ja dhe programi i studimit kanë vënë në zbatim nga fillimi i këtij viti sistemin e ri të LMS (Learning Management System), i cili i mundëson studentit në kohë reale |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|---|--|
| <p>të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p> | <p>të përditësohet on-line me materialet e paraqitura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audiovizive, si dhe vlerësimet për komponentë të caktuar. (Ref. Dok. 1:4 - Strategjita e Zhvillimit të UT 2018-2023; Dok. 3.2 - Strategjia e Zhvillimit të DSHP 2020-2024). Gjithashtu në nivel program-studimi konsorciumi ka përgatitur udhëzuesin e pedagogut për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative TIK të mësimdhënies (Ref. Dok. 3.17 - EuroPS Teaching Handbook, seksioni 4.8)</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>Në nivel programi, konsorciumi ka përgatitur Manualin e Sigurimit të Cilësisë EuroPS për monitorimin e mësimdhënies dhe aftësive kërkimore të stafit. IAL ka disa mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik në mënyrë periodike (Ref. Dok. 2.14 - Rregullore e KPSC). Vlerësimi i kryher nga i) studentët për komponentët e mësimdhënies, vlerësimit dhe sqarimit, këshillimit akademik si dhe një vlerësimi i përgjithshëm; ii) Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSC); iii) njësia e sigurimit të cilësisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale (FSHS) (Ref. Dok. 2.15 - Politika e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies).</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> | <p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve është e garantuar nëpërmjet pyetsorëve si dhe në rast ankimesh studenti mund t'i drejtojë Shefit të Departamentit – i cili është në të njëjtën kohe koordinatori i programit për këtë Master të Bashkuar - me një kërkesë me shkrim për ngritjen e një komisioni për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimit. Deri tani raste ankimore nuk ka patur (Ref. Dok. 1.6 Takim me Studentët dhe Stafin Akademik).</p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>IAL ka strukturën përkatëse të Komisioni të Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë (KPSC), si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Në mënyrë periodike KPSC informon drejtuesit e njësisë, e përmes tyre të gjithë stafin e IAL-së rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. (Ref. Dok. 1.2 - Statuti i UT kreu X; Dok. 1.6 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Takimi me stafin e KPSC).</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon</p> | <p>FSHS promovon shembujt e praktikave më të mira dhe inkurajon stafin nëpërmjet aktiviteteve specifike si për shembull</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|---|----------------------------|---|
| shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies | tavolina të rrumbullakëta apo w orkshops, ndërsa programi që po vlerësohet i organizon këto aktivitete në mënyre periodike edhe në nivel konsorciumi. IAL harton raportet mbi performancën e personelit akademik të cilat përdoren si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit si në drejtim të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punësimit, ashtu edhe të shpërblimit. Rezultatet diskutohen edhe në mbledhje departamenti edhe me pedagogët në mënyrë individuale në fund të vitit akademik kur kryhet vlerësimi i stafit akademik (Ref. Dok. 1.7 - Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit në UT; Dok. 1.6 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Takimi me stafin akademik). | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht X |


| | |
|--|--|
| Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në plan-programin e lëndëve përcaktohen qartë format e mësimdhënies, procesi mësimor dhe transferimi i njohurive. Përveç formave tradicionale të mësimdhënies/mësimnxënies nëpërmjet leksioneve dhe seminarët, detyrave të kursit, projekteve, praktikat profesionale, transmetimi i dijeve e njohurive bëhet edhe nëpërmjet projekteve kërkimore, orëve të hapura, P2P Learning, etj. |
| Kriteri 2. Personeli akademik duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | Në Marrëveshjen e Bashkëpunimit, IAL-të e përfshira në programin e studimit angazhohen që studentët me nevoja të veçanta dhe/ose me sëmundje kronike nuk do të jenë subjekt i asnjë forme diskriminimi. Të gjitha Universitetet partnere janë të përkushtuar të zbatojnë parimet bazë të Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Nevoja të Veçanta, sikurse janë edhe subjekt i ligjeve jo-diskriminuese vendase dhe politikave të diskriminimit pozitiv (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marreveshja e programit, Shtojca A, General Provisions, pika 8, f. 23). Për më tepër, organizimi i programit të studimit ka marrë parasysh edhe kushte e programit përsa i përket tipologjisë së lëndës, tematikës së lëndës, dhe numrit të studentëve si p.sh fakti që në vitin akademik 2020-21, duke marrë parasysh se studentet e regjistruar në vitin e dytë të këtij program studimi ishin |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| | shqipfolëse programi i studimit ka zhvilluar lëndët në gjuhën shqipe me grupet e programeve të tjera të studimit, jo në gjuhën angleze si e parashikon programi i studimit. |
| Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | IAL-ja së bashku me Universitetet partnere mundësojnë përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie si dhe ofrojnë trajnime për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet në ppt ose forma të tjera. Gjithashtu, inkurajohen edhe organizimi i seminareve me ekspertë të ftuar në lidhje me çështje të ekspertizës së tyre sipas tematikave të leksioneve. Platforma online LMS68 e IAL-së dhe Mahara Portfolio dhe EuroPS-Moodle-eLearning e konsorciumit PoSIG69 mundëson dhe e shtrin procesin e mësimdhënies edhe jashtë auditorit. Në kuadër të projektit PoSIG, personeli akademik i programit të studimit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh në universitetet partnere evropiane përgjatë fazës përgatitore të programit të studimit si psh. në Salzburg në mars 2016, në Ljubjanë në prill 2016, në Pavia në maj 2016, si dhe në Sarajevë në qershor 2017. Gjithashtu, përmes programeve të shkëmbit Erasmus+ personeli akademik mësimdhënës ka patur mundësi të japë mësim dhe të përfitojë eksperiencë në universitetet partnere të konsorciumit. (Ref. Dok. 4.5 - <i>Trainime UT dhe FSHS; Takim me stafin akademik</i>) |
| Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojë akademike dhe profesionale në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve që zhvillojnë (Ref. <i>Lista e Pedagogëve te Posig; Takim me stafin akademik</i>). Eksperienca brenda dhe jashtë institucionit, trajnimet e ndryshme dhe publikimet janë bërë të mundur që personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të jetë kompetent në lëndën që zhvillon dhe në metoda didaktike që përdor (Ref. Dok. 3.18 - <i>Raport i Projektit Erasmus</i>). |
| Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Një nga format e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes pyetsorëve të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatën e tyre, si dhe focus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit (Ref. Dok. 3.17 - <i>EuroPS Teaching Handbook and Students Handbook; Dok. 3.18 - Model of Students Questionnaire</i>). Rezultatet e përmbledhura të këtyre vlerësimeve u bëhen me dije nga ana e KPSC-së personelit |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| | akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen (<i>Ref. Dok. 2.18 - Raport i Departamentit 2019-20; Dok. 2.19 - Raport i Departamentit 2020-21; Takim me stafin KPSC</i>). | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Stafi i programit përdor metoda inovative ndërsa përpiqet të tërheqë studentët në diskutime. Zhvillimi i orëve të leksionit kryhet në mënyrë interaktive dhe nëpërmjet diskutimeve me ekspertë të ftuar si dhe platformave online për ta bërë mësimdhënien sa më tërheqëse dhe efektive. Përdorimi i platformës së studentëve ePortfolio është një praktikë e mirë e cila nxit ndërveprimin e studentëve midis institucioneve partnere. (<i>Ref. Dok. 3.17 - Raport i Departamentit EuroPS Teaching Handbook</i>) | | |
| Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre | Në vijim të strategjisë së UT programi përpiqet të inkurajojë mësimin në mënyrë autonome duke i angazhuar me punë të pavarura apo projekte në grup. Diskutimet në orën e seminarit dhe leksionit, dhe prezantimet i japin mundësi studentit të bëjë analiza dhe të shprehë mendimin e tij në mënyrë të pavarur. Gjithashtu përdorimi i ePortfolio i jep mundësi studentit të tregojë se çfarë ka mësuar, të shpalosë kompetencat e veta dhe në të njëjtën kohë të reflektojë progresin e arritur përmes zhvillimit të hapësirës së tij (<i>Ref. Dok. 3.17 - EuroPS Teaching Handbook, pika 4.8 Use of ICT</i>). Gjithashtu, përmes projektit të tezës të masterit, e cila ka një numër të konsiderueshëm orësh 30 kredite, studentët kryejnë punë kërkimore të pavarur nën udhëheqjen e pedagogëve duke dëshmuar se kanë fituar aftësinë për të kryer kërkime të pavarura akademike në fushën e shkencës politike (<i>Ref. Dok. 3.17 - EuroPS Teaching Handbook; Dok. 1.5 - Code of Ethic of UT neni 6</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| | |
|--|--|
| Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe | Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|---|
| mirëmbahen rregullisht. | Ambientet e IAL-së janë të pajisura me sistem kondicionimi, dhe të pastra. Për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit kujdeset stafi administrativ i dedikuar (<i>Ref. Mjediset e FSHS; Vizita në insitucion</i>). |
| Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave. | FSHS ka 6 salla leksionesh dhe 16 salla seminaresh të cilat përdoren me dy turne nga ora 8:00-20:00 dhe janë pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Duhet bërë kujdes për rritjen e numrit të prizave për të mundësuar ngarkimin kompjuterave të studentëve. (<i>Ref. Mjediset e FSHS; Vizita në insitucion</i>). |
| Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. Biblioteka ka 8 kompjuter ofron akses në Sage Library, EbscHOST, si edhe në JSTOR. Kompjuterat janë pajisur me sistemet e operimit është Windows 7, ndërsa paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë, në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor dhe janë të pajisura me sistem wireless (<i>Ref. Mjediset e FSHS; Vizita në insitucion</i>). Infrastruktura ICT në dispozicion të procesit mësimor i mundëson pedagogëve/studentëve të përdorin programet dhe platformat e institucionit dhe ato të programit të studimit si PPT, R, LMS, Moddle eLearning dhe MAHARA Portfolio për të realizuar me sukses programin mësimor (<i>Ref. Dok. 3.17 - Teaching Handbook PoSIG, pika 4.8 Use of ICT</i>). |
| Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit. | Falë e-library dhe modelit të Posig me zhvillimin e vitit të parë akademik në një nga IAL te BE, studentët kanë në dispozicion në formë fizike dhe digjitale të gjithë literaturën bazë dhe ndihmëse, në gjuhën angleze. Si edhe shprehur më lart do duhet të vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin i vazhdueshëm i literaturës edhe nëpër syllabuse për të përfituar nga një databazë literature më e plotë dhe azhurnuar. Kjo garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor të parashikuara për programin e studimit. Literatura e programit miratohet nga shefi departamentit dhe dekani në fillim të vitit akademik (<i>Ref. RVB f.30; Ref. Dok. 4.4 - Te dhena per burimet e literatures qe sigurohen nga Biblioteka FSHS; Takim me studentët; Takim me stafin akademik</i>) |
| Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh | Biblioteka e FSHS ka një sipërfaqe per 195 m2 dhe është në |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



| | |
|--|---|
| të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | permirësim të vazhdueshëm, ndërsa e-library plotëson nevojat e studentëve për literaturën e nevojshme (Ref. <i>Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës; Vizita në bibliotekë</i>). Funksionimi i bibliotekës dhe ambjenteve të saj (regjistrimi, përdorimi i librave/materialeve të ndryshme, detyrat e punonjësve të bibliotekës, si edhe procedurat që duhen ndjekur për pasurimin e bibliotekës) bëhet mbi bazën e rregullores së UT (Ref. <i>Dok. 2.28 - Rregullore e bibliotekës</i>). |
| Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Nëpërmjet platformave eLibrary, studentët dhe pedagogët kanë akses në databaza si SAGE dhe EBSCO, si dhe databazat e universiteteve partnere të programit të studimit të cilat i mundësojnë akses në literaturën më të fundit bashkëkohore edhe të fushave të përafërta me atë të programit të studimit duke përfshirë me mbi 1400 revista shkencore, 60.000 artikuj konferencash, etj (Ref. <i>Dok. 2.29 - Të dhënat e bibliotekës; Vizita në bibliotekë</i>). |
| Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Infrastruktura dhe ambjentet laboratorike të IT-së ndihmojnë studentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre akademike si detyra krusi, prezantime apo tezën e diplomës. |
| Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Pedagogët dhe studentët e programit të studimit kanë akses në platformën online MS Office, përdorimin e LMS dhe EuroPS-eLearning platform. Leksionet, materialet shtesë, detyrat, vlerësimet dhe përgjithësisht gjithë komunikimi zhvillohet përmes platformës online (Ref. <i>Dok.-1.10 - Manual i përdorimit të Microsoft Office për studentët e UT; Takim me studentët</i>). Pedagogët dhe studentët e programit të studimit, përdorin gjithashtu edhe Mahara ePortfolio dhe Moodle eLearning në funksion të procesit mësimor gjatë zhvillimit të vitit akademik në universitetet partnere (Ref. <i>Dok.-1.16 - Udhezues për procedurat e administrimit të projekteve të kerkimit shkencor në UT; Takim me stafin akademik</i>). |
| Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Për komunikime të brendshme si vlerësimet, organizimin e seancave sqaruese dhe çdo komunikimi tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mësimit, studentët përdorin postën elektronike emer_mbiemer.fshsstudent@unitir.edu.al ndërsa pedagogët emer_mbiemer@unitir.edu.al , si edhe EuroPS-eLearning platform (Ref. <i>Dok.-1.15 - Udhezues UT për përdorimin e sistemit të mesimit në distancë; RVB f.31; Takim me studentët; Takim me stafin akademik</i>). |
| Kriteri 10. Personeli akademik orienton | Marrëveshja e bashkëpunimit për programin e studimit |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|---|-----------------------------|--|
| <p>studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistojnë dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p> | <p>parashikon udhëheqjen e studentit nga dy pedagogë (një pedagog duhet të jetë nga Universiteti i Salzburgut apo ai i Lubjanës, ndërsa pedagogu tjetër duhet të jetë nga Universitetet Partnere në Sarajevë, Tiranë, Shkup apo Prishtinë) fusha e kërkimit të cilëve të jetë e lidhur me temën e propozuar nga student (Tema e dizertacionit duhet të jetë e lidhur me një prej dy moduleve të përzgjedhur prej studentit). Gjatë punimit të temës studentët duhet të ndjekin seminarin e tezës që ka për qëllim të ndihmojë studentët të zhvillojnë punimin e tyre. Gjatë seancave metodologjike që zhvillohen për 10 javë, çdo të premtë gjatë semestrit të dytë, studentët orientohen dhe udhëhiqen nga pedagogët në lidhje me temën e diplomës (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Programme Agreement Point 4: Exams Master's Thesis and Master's Thesis Defence, Appendix C). Teza e masterit ka 30 ECTS ndërsa studentët motivohen për të zhvilluar kërkimet shkencore.</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |


| <p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</p> | |
|--|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Senati akademik është struktura kryesore e cila ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përmes komisioneve të përhershme - ku marrin pjesë edhe studentë - siç janë: a) Komisioni për ngritjen në detyrë të personelit akademik; b) Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë; c) Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhëniet me studentët; d) Komisioni i kurrikulës (Ref. Dok. 1.2 – Statuti i UT: neni 29; 37-43). Në sajë të programeve të shkëmbimit Erasmus+ stafi i universitetit dhe stafi i përfshirë në programin PoSIG ka pasur mundësi të fitojë eksperiencë ndërkombëtare përmes mësimdhënies në universitete perëndimore, por edhe përmes pedagogëve të ftuar nga këto universitete për të dhënë mësim në IAL (Ref. Takim me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët</p> | <p>Si njësia përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ofron, departamenti siguron cilësinë në mësimdhënie nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ku bëjnë</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|---|--|
| <p>për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p> | <p>pjesë edhe studentët. Përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, garanton që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, së bashku me koordinatoren e programit si duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimimit nga personeli akademik, ashtu edhe duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar. Stafi akademik dhe studentët janë në djeni të procedurave të vlerësimit të mësimdhënies, gjë e cila rrit vetëdijen për cilësinë e mësimdhënies (Ref. RVJ f.32; Dok. 3.16 - Posig Quality Assurance Document; Takim me Stafin Akademik dhe studentët).</p> |
| <p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> | <p>Në nivel institucional por edhe në nivel program-studimi, IAL-ja së bashku me konsorciumin inkurajojnë zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes përdorimit të sistemit LMS dhe EuroPS-Moodle-eLearning. Konsorciumi ka përgatitur udhëzuesin e pedagogut për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative TIK të mësimdhënies (Ref. Dok. 3.17 - EuroPS Teaching Handbook, seksioni 4.8). Gjithashtu, është përcaktuar formati që përdoret për hartimin e plan-programeve, me një seksion të veçantë për metodat e mësimdhënies (Ref. Dok. 3.18 - Formatit për hartimin e silabusit).</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Stafi akademik i angazhuar në përgatitjen e programit të studimit PoSIG ka marrë pjesë në disa trajnime që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor si psh. SEEDS: rëndësia e arkivimit të të dhënave studimore në Shkencat Sociale në Shqipëri më 18 maj 2017; Conference: Bridges Within Europe- Sarajevo, BiH më 7-11 qershor 2017; How to publish your research më 29 qershor 2017, Staff Development (Pedagog Plus) më 4-5 korrik 2017; Metodologjitë e Kërkimit Inovativ nga COORP dhe Sussex University më 7-10 nëntor 2017; Undertaking and Publishing Impactful Research më 24-25 prill 2018; Metoda Kërkimi Sasiore – European Social Survey, 12 mars 2019; Winter School: European Social Survey round 9 in Albania, 8-9 mars 2019 (Ref. Dok. 4.3 - Te dhena tabelore per personelin akademik; RVB fq.32).</p> |
| <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> | <p>Trajnimi i personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, është kryer vetëm nëpërmjet periudhave të shkurtra të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programit Erasmus+, si dhe trajnimeve të organizuar nga anëtarë të personelit të zyrave të ndryshme të IAL-së (Ref. (Ref. Dok. 4.5 -</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Staff Training in Salzburg; Takimi me Zyrën e Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë, Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë; Takim me stafin akademik).</i> | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Në ndihmesë të personelit akademik për përmirësimin dhe sigurimin që mësimdhënia realizohet në nivel të lartë në çdo institucion partner, konsorciumi ka hartuar manualin për mësimdhënie të mirë. Ky manual ofron udhëzime të dobishme për stafin e angazhuar në programin e studimit (<i>Ref. Dok. 3.17 - Teaching Handbook PoSIG</i>). | | |
| Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitet përgjegjëse. | Raportimi i rezultateve të aplikimit të metodave të reja në mësimdhënie kryhet nga vetë pedagogët dhe përfshihet në vetvlerësimin e përgjithshëm të performancës së punës së tyre mësimore dhe kërkimore (<i>Ref. Dok. 3.17 - Teaching Handbook PoSIG</i>), por nuk ka ndonjë procedurë specifike dhe periodike të një analize mbi efektet dhe pritshmëritë. | | |
| Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | Në kuadër të programit Erasmus+, janë përfshirë në mësimdhënie për një periudhë të shkurtër pedagogë nga IAL partnere pranë universitetit të Salzburg duke shkëmbyer edhe ekspriencën e mbledhur ku pedagogët sjellin analiza dhe shembujt konkretë të praktikave të suksesshme me qëllim që rezultatet e të nxëniet të jenë më të larta (<i>Ref. Dok. 3.16 -PoSIG; Quality Assurance Document; Dok. 4.5 -Staff Training in Salzburg</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi III.5 | |
|--|--|
| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Rregullorja e përgjithshme e IAL-së, përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale (<i>Ref. Dok. 1.3 -Rregullore UT, neni 45</i>). Studentët njoftohen mbi këtë rregullore dhe aktet e tjera rregullatore të FSHS gjatë javës së (parë të fillimit të studimeve) orientimit, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse (<i>Ref. Dok. 2.4 - Rregullore FSHS, neni 44</i>). Në vijim, studenti informohet edhe nga Koordinatorja e programit, pedagogët dhe zyra e |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| | sekretarisë mësimore (<i>Ref. Takim me studentët</i>). Studentët e këtij programi studimi, kanë për bazë Marrëveshjen e Programit e cila është e aksesueshme online dhe i informon specifikisht ata edhe për mënyrën e zhvillimit dhe vlerësimit të testimit dhe tezës (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marreveshja e programit, Pika 4 Exams Master's Thesis and Master's Thesis Defence, Appendix C</i>). | | |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të lëndë për çdo semester, titullari i lëndës i njej studentët me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Në vazhdimësi, njoftimet e detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me e-mail nga koordinatozja e departamentit (<i>Ref. RVB f.33, Takim me studentët</i>). | | |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Në të gjitha lëndët, performanca e studentit vlerësohet drejtpërdrejt, arritja e objektivave të të mësuarit vlerësohen përmes detyrave me shkrim dhe / ose me gojë. Studenti vlerësohet për angazhimin në diskutime, për detyrat tematike dhe esetë e përgatitura përgjatë seancave mësimore, si dhe provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marreveshja e programit; Dok. 3.15 - Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit te studentëve</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| | |
|--|---|
| Standardi III.6 | |
| Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në varësi të pikëve të grmbulluara si nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të aktiviteteve didaktike të përcaktuara në plan-programin e lëndës të shprehura si përqindje e notës përfundimtare. Forma dhe pesha e kontrollit të dijeve ndryshon në IAL është e njëjtë me atë në marrëveshjen e programit të studimit të konsoriumit i.e. 60% me detyrat dhe aktivitetet gjatë kursit dhe 40% i dedikohen projektit/provimit përfundimtar. (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG: Marrëveshje e Programit Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit te studenteve</i>). |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të | Në vlerësimin e njohurive të lëndës, nuk përdoren sisteme elektronike për kontrollin e provimeve. Ndërkohë, institucioni |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|---|---|
| <p>testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>përdor programin turnitin/ephorous për të evituar plagjaturë e eseve dhe temave të diplomës. Mbrojtja e Temës së Diplomës është një provim publik para një bordi provimi të përbërë nga të paktën një pedagog (i fushës të specializimit i zgjedhur nga studenti) nga secili universitet ku studenti ka marrë pjesë gjatë studimit të tij (min. 2 dhe maksimumi 4 instruktorë), dhe drejtohet nga koordinatori EuroPS i universitetit ku studenti ka përfunduar studimin (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marrevshja e programit, Pika 4 Exams Master's Thesis, Master's Thesis Defence, Appendix C).</p> |
| <p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Për vlerësimin e provimeve nuk angazhohen anëtarë të tjerë përveç titullarit të lëndës. Vetëm në rastin kur lënda zhvillohet nga më shumë se një pedagog, atëherë pedagogët që e kanë zhvilluar lëndën përfshihen edhe në vlerësimin përfundimtar. Komisioni për vlerësimin (notën) e tezës së masterit përbëhet nga 2 pedagogët e moduleve kur tema zgjidhet nga studentët dhe 2 koordinatorët e programit ku një është nga Universiteti i Salzburg dhe një nga UT. Vlerësimi bëhet nga (min. 2 dhe maksimum 4 pedagogë) me konsensus ose kur nuk është e mundur arritja e një konsensusi, vendoset nga shumica e 2/3-ve (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marrevshja e programit, Pika 4 Exams Master's Thesis and Master's Thesis Defence, Appendix C).</p> |
| <p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p> | <p>Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare përgatiten nga pedagogu përkatës i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore (Ref. Dok. 1.3 - Rregullore e UT neni 48; Dok. 2.4 - Rregullore e FSHS neni 47).</p> |
| <p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Rregulloret e IAL-së parashikojnë vlerësim të detajuar për çdo pyetje si edhe dhënien e sqarimeve përpara provimit dhe argumentimet për vlerësimin e marrë nga studenti për çdo detyrim të lëndës pas provimit (Ref. Dok. 1.3 - Rregullore e UT neni 51). Në disa lëndë si p.sh. Politika Sociale, Politika Publike dhe Insitucionet parashikohet edhe dhënia e komenteve dhe kotributeve të studentëve për studentët e tjerë në formën e P2P review (Ref. RVB fq.34; Takim me pedagogët).</p> |
| <p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>Gjatë zhvillimi të provimeve, ambjenti monitorohet nga dy pedagogë të caktuar nga Departamenti, telefonat celularë duhet të jenë të fikur. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese (Ref. Dok. 1.5 - Kodi Etikës i UT, Neni 5, 6). Pedagogu mund të përdorë programin turnitin/ephorous</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | për të evituar plagjaturinë e eseve dhe temave të diplomës. | | |
| Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Sekretimi i provimeve me shkrim altermohet me atë në sistemet elektronike të provimeve me zgjedhje duke siguruar një proces transparent të vlerësimit. Teza e provimit është hartuar duke marrë parasysh njohuritë e fituara dhe korrigjohet brenda 15 ditëve duke u dhënë mundësinë studentëve të kenë edhe mundësinë e ankimit (Ref. Dok. 1.3 - Rregullore e UT neni 49; Dok. 2.4 - Rregullore e FSHS neni 48) | | |
| Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Rezultatet e vlerësimeve të provimeve dorëzohen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre, Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. Studenti ka të drejtë të ankimohet për rezultatin tek përgjegjësi i departamentit brenda 24 orëve dhe në rast se ky i fundit verifikon shkelje të korrigjueshme në bashkëpunim me komisionin e provimit ben korrigjimet e nevojshme (Ref. Dok. 1.3 - Rregullore e UT neni 49; Dok. 2.4 - Rregullore FSHS neni 48). Për rezultatet e vlerësimit pedagogu do të zhvillojë seancës sqaruese. Gjatë kësaj seance, pedagogu i jep mundësi çdo studentit të shikojë vlerësimin duke e informuar në lidhje me përgjigjet e pyetjeve dhe elementët ku ai ka gabuar. | | |
| Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ai mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me kërkesë për rivlerësim brenda 48 orëve, i cili bën vlerësimin dhe në rast se nuk mund ta zgjidhë informon dekanin. Ky i fundit mund të vendosë ngritjen e një komisioni rivlerësimi. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar (Ref. Dok. 1.3 - Rregullore e UT, Neni 50). Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi III.7


Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të... garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> | <p>Programi i studimit i mundësom studentit që të krijojë profilin e tij akademik duke zgjedhur në mënyrë të pavarur dy nga gjashtë modulet të clat i krijojnë mundësi për studime të thelluar në fushat respektive, si dhe universitetin ku do të kryejë vitin e dytë dhe lëndët me zgjedhje. Kurset e avancuar në metodologji dhe lëndë aplikative plotësojnë orientimin substancial të moduleve të programit. Kjo mënyrë organizimi ndihmon studentët të kryejnë në mënyrë të pavarur kërkim shkencor dhe të zhvillojnë strategji kërkimore, të thellojë njohuritë për zhvillimin e aftësitë profesionale dhe të veçanta (Ref. Dok. 3.15 - Posig Study Programme Annex1).</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>Përveç aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e studimit, për shkak të karakterit ndërkombëtar të programit të studimit, larmishmërisë së moduleve dhe lëndëve, mboliteti i studentit dhe ambjenti multikulturo, të gjithë këta elementë i krijojnë mjaftueshëm mundësi studentit për zhvillimin e aftësive të veçanta si dhe reflektime individuale. Studenti fiton aftësi organizative, aftësi komunikimi ndërkulturore, si dhe zgjeron perspektivën në fushën e qeverisjes dhe integritimit në BE (Ref. Dok. 3.15 - Posig Study Programme Annex1).</p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p> | <p>Si rregull, në përfundimit të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu eseja apo detyra e kursit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda (Ref. Dok. 3.15 - Posig Study Programme Annex 4; Takimi me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p> | <p>Në përfundim të lëndës pedagogu rikthen në fokus për studentët çështjet apo konceptet më të rëndësishme të trajtuara si dhe jep orientimet e nevojshme për përgatitjen për provim. Kjo është një praktikë që zbatohet nga programi në javën e 15 te semestrit. Pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit. (Ref. Dok. 3.15 - Posig Study Programme Annex 4; Takimi me stafin akademik).</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor, për të ndarë eksperiencat novatore e pozitive, si edhe për informuar kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit të disiplinave dhe fushave të tyre të</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|---|--|
| | studimit (Ref. Dok. 4.9 Mesimdhënia inovative dhe te tjera. RVB f. 36; Takimi me stafin akademik). |
| Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Mësimdhënia në këtë program studimi harmonizon njohuritë teorike me aspektin praktike, përmes projekteve tematike apo detyrave të kursit ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra (Ref. Dok. Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Dok. 4.2). Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila nën mbikqyret nga një pedagog i departamentit ndihmon në rritjen e aftësive profesionale dhe mundësi më të mira për integrimin në tregun e punës. (Ref. Dok. 4.1 - Plani mësimor i programit të studimit; Takimi me stafin akademik) |
| Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | Përmes detyrave të kursit simulimit të situatave reale apo edhe diskutimet me ekspertë të jashtëm, stafi akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore, ndonëse nuk ka aktualisht një përfshirje të studentëve në kuadër të projekteve apo grupeve kërkimore të organizuara në nivel njësie bazë (Ref. Dok. 4.6 - Lista e projekteve që kane patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Takimi me stafin akademik dhe studentët) |
| Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Personeli akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore në kuadër të projekteve apo grupeve kërkimore të organizuara në nivel njësie bazë. (Ref. Takimi me stafin akademik dhe studentët). Për të nxitur një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, stafi akademik perpiqet të organizojë dhe mbështesë studentët në zbatimin e aktivitete specifike me pjesmarrjen e aktorëve të jashtëm si p.sh. konferenca Integrimi Evropian i Ballkanit Perendimor: Qëndrueshmëria, Dështimet dhe Sfidat. |
| Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Programi synon vendosjen e kërkimit shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, por edhe transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtari kërkimore, si rasti i revistës periodike "Politika" i cili kishte si qëllim zhvillimin e analizës kritike dhe zhvillimin e njohurive të studentëve mbi këtë temë të rëndësishme (Ref 2.26 Politika për mbështetjen e studneteve dhe strukturat e tyre organizative). FSHS akordon edhe një fond për këshillat studentore për të diskutuar dhe ngritur aspekte me interes për kërkimin shkencor, përmirësimin e mësimshënies apo edhe cilësinë e shërbimeve. Kostoja e publikimeve të studentëve si |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------|-----------------------|
| | në aktivitet ashtu edhe në atë të përmendur më lart janë mbuluar nga institucioni (<i>Ref 2.26 Politika per mbeshitetjen e studneteve dhe strukturat e tyre organizative; Takim me Stafin Akademik</i>). | | |
| Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | Mobiliteti Ndërkombëtare është pjesë integrale e detyrueshme e këtij programi studimi. Studentët e këtij programi duhet të kryejnë studimet e tyre në të paktën dy, dhe maksimumi katër nga universitetet partnere të konsorciumit (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marreveshja e programit; pika § 9 Lëvizshmëria</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht |
| | | | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi III.8 | |
|--|--|
| Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Mbrojtja e Temës së Diplomës është një provim publik para një bordi, e cila zgjat maksimumi 60 minuta. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës Për notën e tezës së masterit vendos bordi i provimit (min. 2 dhe maksimum 4 pedagogë) me konsensus ose kur nuk është e mundur arritja e një konsensusi, vendoset nga shumica e 2/3-ve. Në universitetet ku teza e masterit dhe mbrojtja e saj vlerësohen veçmas, mbrojtja e tezës i korrespondojnë 2 kredi ECTS nga 30 kreditë ECTS të gjithë Tezës së Masterit. Procedura specifike që ndiqet për mbrojtjen finale të Tezës Master është e përcaktuar në marrëveshjen për ofrimin e programit (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marreveshja e programit; pika § 13 Master's Thesis Defence</i>). |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij. Studenti udhëhiqet nga dy pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit të studentit. Për përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nëpërmjet ofrimin të informacionit të nevojshëm në lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës si edhe një seminar metodologjie për të mbështetur studentët me zhvillimin e tezës (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marreveshja e programit; pika § 8 Master's Thesis</i>). Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera (LMS, Mahara, Moddle) që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p> | <p>Sic u përmend më lart, marrëveshja e bashkëpunimit të programin e studimit parashikon udhëheqjen e studentit nga dy pedagogë - një pedagog duhet të jetë nga Universiteti i Salzburgut apo ai i Lubjanës, ndërsa pedagogu tjetër duhet të jetë nga Universitetet Partnere të Ballkanit Perendimor - fusha e kërkimit të të cilëve të jetë e lidhur me temën e propozuar nga student. Gjatë punimit të temës studentët duhet të ndjekin seminarin 10 javor të tezës për tu orientuar dhe udhëhiqen nga pedagogët në lidhje me temën e diplomës (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marrëveshja e programit; pika § 13 Master's Thesis Defence). Takim me Stafin Akademik). Mentorimi i studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratur nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe mentorin bëhet pranë kordinatorit të programit i cili harmonizon kërkesat e studentëve me mundësitë reale pa çënuar cilësinë e punimeve të diplomave dhe duke evituar përsëritjet.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Procesi i mbikëqyrjes së tezës së masterit është i dokumentuar në ePortfolio të studentit (pjesë e platformës PoSIG eLearning). Në këtë platformë përfshihet një ekspozë me pyetjen kërkimore dhe qasjen metodologjike, si dhe komentet e mbikqyrësve mbi ekspozenë e studentit (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marrëveshja e programit; pika § 13 Master's Thesis Defence).</p> |
| <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Në ePortfolio të studentit, si detyrim i procesit të mbikëqyrjes së tezës së masterit, përfshihet gjithashtu vlerësimi i tezës nga dy pedagogët udhëheqës (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marrëveshja e programit; pika § 13 Master's Thesis Defence).</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> | <p>Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos bordi i provimit (min. 2 dhe maksimum 4 pedagogë) me konsensus ose kur nuk është e mundur arritja e një konsensusi, vendoset nga shumica e 2/3-ve. Në universitetet ku teza e masterit dhe mbrojtja e saj vlerësohen veçmas, mbrojtja e tezës i korrespondojnë 2 kredite ECTS nga 30 kreditë ECTS të gjithë Tezës së Masterit (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marrëveshja e programit; pika § 13 Master's Thesis Defence).</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të kompletimit të shlyerjeve akademike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratura nga ministria respektive për arsimin dhe e firmosur prej universiteteve partnere ku studenti ka zhvilluar studimet e Masterit të Përbashkët (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marreveshja e programit</i>). | | |
| Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Me kërkesë të vetë studentit, ai mund të marrë një kopje zyrtare të silabuseve të programit të studimit të zhvilluar, si edhe shtojcën e diplomës që përmban edhe: sistemin (apo mënyrën e studimit),karakteristikat akademike të programit titullin e marrë, si edhe detaje të tjera rreth programit (<i>Ref. Dok. 1.2 - Statuti i UT neni 111</i>). | | |
| Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen | Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Dokumentacioni bazë përbëhet nga: regjistri bazë i studentëve; regjistri i arritjeve akademike; dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vet institucionit (<i>Ref. Dok. 2.9 Rregullore e sekretarisë mësimore; Vizitë në Sekretarinë Mësimore</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | | | |
|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


| | |
|--|--|
| Standardi IV.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e | Në këtë program studimi numri i stafit akademik i angazhuar nga IAL është 7. Pranë zyrës së burimeve njerëzore është i |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| <p>personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar. Zyra e Burimeve Njerëzore e Fakultetit e mban bazën e të dhënave e personalit të angazhuar në programin e studimit. Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit. Zyra e Burimeve Njerëzore të Fakultetit mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër (Ref. RVB, fq. 40; Dok. Te dhena tabelore per personelin akademik; Takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit).</p> | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> | <p>Institucioni dhe Fakulteti ka procedurë që përcakton politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Procedura e rekrutimit është në përputhje me aktet ligjore dhe me rregulloret. Procedura e rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore të Fakultetit. Nevojat për burime njerëzore të programit të studimit PoSIG deri më tani janë mbuluar nga burimet njerëzore ekzistuese të Departamentit (Ref: RVB, fq. 40; Dok. Informacion per politiken e burimeve njerëzore dhe vleresimin e personelit; Takime me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit dhe me GVB).</p> | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> | <p>Procedura e rekrutimit e personalit për nevojat e programit të studimit PoSIG u përcaktua nga marrëveshja ndër-institucionale dhe u zbatua nga koordinatorët e programit. Jo çdo anëtar i propozuar i personelit akademik u pranua për të dhënë mësim në program (Ref. RVB, fq. 40-41; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB).</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p> | <p>Lektorët e lëndëve që ata japin në kuadër të PoSIG kanë plotësuar kriteret siç janë: eksperiencë në kërkim shkencor dhe mësimdhënie, përputhje me kërkesat e kurrikulës së PoSIG-ut në lidhje me lëndët, etj. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë nevojat e moduleve të programit të studimit (Ref: RVB, fq. 41; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> |


| | |
|---|--------------------------------------|
| <p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> | <p>Mjediset e vendosura në dispozicion për nevojat e programit të studimit PoSIG janë të përshtatshme. Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik. Nga vizita në institucion mund të konstatohet që institucioni ka mjediset me kushte funksionale dhe të përshtatshme (<i>Ref. RVB, fq. 41; Vizita në institucion; Dok. 4.7 - Të dhëna për infrastrukturën</i>).</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> | <p>Institucioni realizon disa incentive të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafit përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, dhe mobilitete, dhe përmes skemës së re për financimin e kërkimit shkencorë mbështeten për përfshirje në hulumtim. Personeli që mbulon dhe administron programin e studimit pati mundësi për t'u trajnuar në kuadër të programit Erasmus që financoi zhvillimin e programit të studimit PoSIG. Përfshirja në një numër të konsiderueshëm projektesh ndërkombëtare është një tregues i rëndësishëm në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të personelit (<i>Ref. RVB, fq. 41; Dok. Te dhëna për mobilitetin e studenteve dhe të pedagogëve; Dok. Te dhëna për aktivitetet për kualifikimin për kërkim shkencor të personelin akademik për 5 vitet e fundit; Takimi me stafin akademik; Takimi me Pergj. Dep</i>).</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p> | <p>Universiteti inkurajon përmes përfshirjes së stafit akademik në projekte kërkimore me partnerë ndërkombëtar, programet Erasmus dhe Jean Monnet etj, mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni organizon aktivitete dhe mbështet anëtarët e stafit për të ndërmarrë metoda inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja (Meet, Zoom) si dhe mbështet stafin në kërkim shkencor nëpërmjet projektsh dhe me fondin e re për hulumtim shkencor. Anëtarët e stafit janë aktiv në kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe botimeve (<i>Ref. RVB, fq. 41; Dok. 4.6 Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Takimi me stafin akademik</i>).</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p> | <p>Stafi i angazhuar në programin e studimit PoSIG është me tituj dhe grada në fushën e programit të ofruar. Programi i studimit PoSIG nga ana e Universitetit të Tiranës mbulohet nga 3 Profesor të Asociuar dhe 4 Doktor Shkencash. Profesionalizmi dhe kualifikimi i tyre mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe angazhimi i tyre është në nivelin e kërkuar. Institucioni angazhon personelin e duhur si për të ofruar</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | programin ashtu edhe për aktivitetet plotësuese. Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete ndihmëse mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave, por duke mbajtur parasysh që kjo të mos sjellë një mbi-ngarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës (Ref: RVB, fq. 42; Dok. Te dhena tabelore per personelin akademik; Takimet me GVB dhe me stafin akademik). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi IV.3 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Studentët e programit PoSIG kanë në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit të pjesët teorike të programit të studimit. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme. Numri dhe kapacitet e klasave janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit (Ref: RVB, fq. 42; Dok. 4.7 - Të dhëna për infrastrukturën; Vizita në institucion). |
| Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjiive e teknologjiive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Mjediset e ofruara nga institucioni janë të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si projektor, internet dhe me tabela smart. Përdorimi nga ana e studentëve dhe stafit akademik të sistemit MOODLE/LMS (Sistemi i Menaxhimit të Mësimimit) mundëson përdorimit të metodologjiive e teknologjiive bashkëkohore të aksesueshme në çdo kohë për materialet e hedhura nga pedogogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. (Ref: RVB, fq. 42; Dok. 4.7 - Të dhëna për infrastrukturën; Vizita në institucion). |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit | Për natyrën që ka ky program mësimor nuk ka të nevojshme praktika në laborator. Por, klasat janë pajisur me mjete audio vizive në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor (Ref: RVB, fq. 42; Dok. 4.7 - Të dhëna për infrastrukturën; Vizita në institucion). |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| të studimit në tërësi. | | | | | | | |
|--|---|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|---|
| Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Institucioni ka 1 laborator të teknologjisë së informacionit (Salla e Doktoraturave) që është në dispozicion për programin studimit PoSIG (Ref: RVB, fq. 42; Dok. 4.7 - Të dhëna për infrastrukturën; Vizita në institucion). | | | | | | |
| Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | Kapacitetet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. Studentët e këtij programi studimi kanë kryer praktikën e tyre profesionale në Austri siç janë organizatat e specializuara për të drejtat e njeriut dhe në Shqipëri siç janë kompanitë mediatike (Ref: RVB, fq. 42; Dok. 4.7 - Të dhëna për infrastrukturën; Vizita në institucion). | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | X |
| Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| Standardi IV.4 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Në nivel Fakulteti është një bibliotekë e vendosur në katin e 2-të me një sipërfaqe 200m ² e pajisur me 8 PC, sistemi wireless dhe si një sallë leximi me 74 ulëse. Studentët e programit PoSIG kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekat fizike të universiteteve partnere ku kryejnë studimet (Ref: RVB, fq. 43; Dok. 2.28 - Rregullore e bibliotekës; Dok. 2.29 - Informacion për bibliotekën; Vizita te institucioni). |
| Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Literatura te Biblioteka është e mjaftueshme me botime në shqip, anglisht dhe gjuhë të tjera. Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online (në libraritë elektronike JSTOR, Ebsco). Gjithashtu, një mundësi tjetër është Biblioteka online e ofruar na Konsorciumi PoSIG (Ref: RVB, fq. 43; Dok. 2.30 - Buxhetimin për pasurimin të bibliotekës në vitin e |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>fundit në nivel fakulteti; Dok. 2.31 - Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS; Dok. 4.4 - Të dhëna për burimet e literaturës që sigurohen nga Biblioteka FSHS; Vizita te institucioni).</i> | | |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë, përfshirë bibliotekat on-line, është pa pagesë. Ndërsa disa nga këto burime në internet janë të aksesueshme pavarësisht nga vendndodhja, shumica e këtyre burimeve mund të aksesohen vetëm nëpërmjet objekteve të bazuara në universitet (<i>Ref: RVB, fq. 43; Dok. 2.28 - Rregullore e bibliotekës; Dok. 2.29 - Informacion per bibliotekën; Vizita te institucioni).</i> | | |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Në ambjentin e bibliotekës ndodhen 8 PC që janë në dispozicion të studentëve dhe të cilat mund të aksesohen lirisht nga studentët. IAL është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore (<i>Ref: RVB, fq. 43-44; Dok. 2.28 - Rregullore e bibliotekës; Dok. 2.29 - Informacion per bibliotekën; Vizita te institucioni).</i> | | |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Çdo vit sipas kërkesave të studentëve dhe të stafit akademik, po përgatitet një listë të re blerjesh për të pasuruar fondin. Kërkesat për pasurimin e fondit të bibliotekës vinë nga departamentet. Nga takimi që patëm me stafin akademik na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e tyre për literaturë plotësuese. Pasurimi i fondit të bibliotekës bëhet edhe përmes botimet nga stafit të Fakultetit (<i>Ref: RVB, fq. 44; Dok. 2.30 - Buxhetimin për pasurimin të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti; Dok. 2.31 - Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS; Dok. 4.4 - Të dhëna për burimet e literaturës që sigurohen nga Biblioteka FSHS; Vizita te institucioni).</i> | | |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 08.00-17.00. <i>Oraret e shërbimit të bibliotekës janë përshtatur me oraret e programit të studimit, por jo përtej tyre (Ref: RVB, fq. 44; Dok. 2.28 - Rregullore e bibliotekës; Dok. 2.29 - Informacion per bibliotekën; Vizita te institucioni).</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|------------|--|--|--|---|
| standardit | | | | X |
|------------|--|--|--|---|


| Standardi IV.5 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Universiteti i Salzburgut, si drejtues kryesor të programit PoSIG ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur. Ky program informatik realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin automatik me anë të email-it për aktivitete të ndryshme, regjistrimi në kurse apo programe të ndryshme. Paralelisht, Universiteti i Tiranës ruan të dhënat e studentëve të regjistruar në program (<i>Ref. RVB, fq. 44; Dok. Raport per veprimtarine e programit te studimit; Takim me GVB</i>). |
| Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Platforma e programit mundëson komunikimin, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Platforma është e adaptueshme për nevojat e studentëve ose anëtarëve të stafit akademik (<i>Ref. RVB, fq. 44; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB</i>). |
| Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi i menaxhimit që përdoret mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentet. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog (<i>Ref. RVB, fq. 44; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB</i>). |
| Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Përmes sistemit institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (<i>Ref. RVB, fq. 45; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB</i>). |
| Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Përmes përdormimit të këtij sistemi realizohet gjithashtu monitorimi në kohë reale i aktivitetit administrativ dhe akademik (<i>Ref. RVB, fq. 45; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB</i>). |
| Kriteri 6. Informacionet që lidhen me | Në faqet e internetit të Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | të Shkencave Sociale gjendet informacion në lidhje me programin e studimit. <i>Por, informacioni i dhënë është shumë i kufizuar dhe është vetëm në gjuhën shqipe. Programi i studimit meriton një publicitet më të mirë në faqet e internetit të Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale (Ref. RVB, fq. 45; Takim me GVB; vizitë në faqen e internetit të institucionit dhe të Fakultetit).</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi IV.6 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Buxheti financiar të programit hartohet nga Universiteti i Salzburgut, si Koordinator kryesor i këtij programi. Koordinator nga Departamenti i Shkencave Politike depoziton çdo vit mbështetjen financiare në lidhje me programin pranë Zyrës Financiare të Universitetit të Tiranës (Ref. RVB, fq. 45; Takim me GVB). |
| Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | Plani i financimit hartohet nga Universiteti i Salzburgut, si Koordinator kryesor i këtij programi (Ref. RVB, fq. 45; Dok. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Takim me GVB). |
| Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të | Universiteti i Salzburgut, si Koordinator kryesor i këtij programi, kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit, me monitorimin nga EACEA, e cila ka akorduar fonde për nevojat e programit në kuadër të Erasmus+ (Ref. RVB, fq. 45; Dok. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Takim me GVB). |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | | | | | | | | | |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Koordinatori nga Departamenti i Shkencave Politika depoziton çdo vit mbështetjen financiare në lidhje me programin pranë Zyrës Financiare të Universitetit të Tiranës (Ref. RVB, fq. 45; Dok. Raport per veprimtarine e programit të studimit; Takim me GVB). | | | | | | | | |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | Fakti që programi i studimit është i bashkëorganizuar me universitete të tjera dhe fakti që programi u financua nga programi Erasmus+, lehtëson funksionimin financiar të programit (Ref. RVB, fq. 45; Dok. Strategjia e zhvillimit te programit te studimit; Takim me GVB). | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| | |
|--|--|
| Standardi V.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjisllacionin në fuqi | UT realizon pranime në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar edhe në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe vendimet e Senatit. |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| dhe aktet e veta rregullatore. | Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, dhe në broshurën informuese specifike të programit të studimit PoSIG. Për programin e studimit PoSIG është aplikuar kriteret shtesë në përputhje me Marrëveshjen e Universiteteve Partnere EuroPS Agreement on the Joint Master's Programme in Political Science – Integration and Governance që specifikon procedurat e pranimit, programin e lëndës, testimin, praktikës profesionale dhe diplomimit të studentëve. Rregjistrimi i studentëve realizohet në Universitetin e Salzburgut dhe jo në atë të Tiranës. <i>Ekziston nevoja për të patur një rregullore specifike të UT për programin e studimit PoSIG që do të lehtësojë funksionimin e programit.</i> (Ref. Dok. 3.15 - <i>EuuroPS Agreement on PoSIG; Faqa programit: http://euro-ps.org/admissions/</i>). |
| Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Te gjitha kriteret funksionale nga rregjistrimi deri në diplomimin e studentëve janë të specifikuar në Aneksat e Marrëveshjes së programit PoSIG. Në bazë të dokumentacionit të shqyruar rezultojnë se politikat dhe procedurat e ndjekura përpara pranimit dhe përfundimit të studimeve janë të njëjta për të gjithë studentët. Të njëjtat rregulla aplikohen për të gjithë dhe të vetmet raste përjashtimore janë studentët me nevojë të veçanta për të cilët mund të ketë rregullime të ndryshme në lidhje me formën e testimin (Ref. Dok. 3.15 - <i>Marrëveshje e Universiteteve Partnere PoSIG</i>). |
| Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Studentët kanë mundësi që të aksesojnë kriteret dhe procedurat sipas shtojcës 2b2 të Konventës së vlerësimit. Kriteret dhe procedurat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme online në faqen e programit (Ref. Dok. 3.15 - <i>2b2 Kriteret dhe procedurat; Shtojca 2b3; Vlerësimi intervistës; Konventa e vlerësimit; Mbështetja e studentëve: http://euro-ps.org/frequently-asked-questions-faq/</i>). |
| Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | FSHS dhe UT publikojnë çdo vit thirrjen e hapur për pranimin në Master PoSIG. Vendimi për pranimet publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, publikohen në faqen e UT (Ref. https://plus.ac.at/political-science/studies/joint-master-political-science-integration-and-governance-posig/?lang-eng ; http://posig.info/about-posig/). |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta | Me hapjen e pranimeve FSHS është koordinatori për programin PoSIG dhe organizon forma të informimit, prezantimit, orientimit dhe mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| të programit të studimit | sociale etj. Thirrja për PoSIG bëhet në maj: nga viti 2017-2020, prezantimet e PoSIG zhvillohen në kuadër të modulit Jean Monet: “Integrimi Evropian dhe Qëndrueshmëria e Ballkanit Perendimor” (Ref. RVB, fq. 47; Faqa zyrtare e programit: https://plus.ac.at/political-science/studies/joint-master-political-science-integration-and-governance-posig/?lang-eng ; http://posig.info/about-posig/). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |


| Standardi V.2 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | UT vë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret, procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin në fillim të vitit akademik, nërsa shfrytëzimi i platformave LMS, mundëson një informacion dhe njohjen e përparimeve akademike nga studentët në kohë reale. Krahas sekretarisë mësimore, koordinatori i programit mundëson gjithashtu dhënien e informacionit për rregullat e frekuentimit, kurset e detyrueshme apo integruese, modulet karakterizuese apo me zgjedhje, praktikën, temën e diplomës sezonet e provimeve, si edhe me numrin e krediteve që marrin për çdo lëndë, semestrin që duhet ta ndjekin dhe universitetin që e ofron(Ref. Dok. 3.15 - Rregullore e Programit https://euro-ps.org/curriculum/ ; Shtojca 1 Kurrikula për Masterin; Konventa e notave). |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | UT informon studentët e tij të PoSIG mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informon studentët mbi këto procese. Ky proces kryhet si në fillim të programit ashtu edhe gjatë zhvillimit të tij duke patur parasysh që është një program i përbashkët i disa universiteteve. Në fillim të programit studentët informohen se çfarë diplomash njihen në universitetet partnere, ndersa me përfundimin e viti të parë në një universitet, kryhet njohja e notave, dhe krediteve nga universiteti ku zhvillohet viti i dytë i programit .(Ref. RVB, fq. 47 Dok. 3.15 - Appendix 1 Curricula for the Master Degree). |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e | Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | online nga studentët, gjithashtu në fillim të çdo semestri ata informohen dhe nga stafi akademik mbi procedurat e vlerësimit të dijeve. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit parashikohen në Kurikulumin e programit të studimit. Ato janë edhe pjesë e silabuseve të lëndëve, të cilat i vihen në dispozicion dhe i shpjegohen studentëve që në fillim të procesit akademik (Ref. Dok. 4.2 - Silabuset e lëndëve; Takim me stafin akademik; Faqa zyrtare e programit: https://euro-ps.org/curriculum/). | | |
| Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Institucioni organizon seanca informimi mbi punimin e diplomës. Studentët janë udhëzuar mbi literaturën dhe formatin e testimit. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura te Kalendarit Akademik (Ref. RVB, fq. 54; Dok. 3.15 - Shtojca 1 Kurrikula për Masterin; Konventa e notave; Takim me stafin akademik). | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Departamenti i Shkencave Politike si koordinator i programit ka disa forma për informimin e studentëve të ardhshëm mbi PoSIG si: organizimi në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit”, mbledhjet e departamentit, të hapura për studentët e interesuar, materialet informuese, faqja zyrtare e programit e cila përditësohet rregullisht, si edhe ëorkshop i modulit Jean Monet: “Integrimi Evropian dhe Qëndrueshmëria e Ballkanit Perendimor” (Ref. Takim me stafin akademik; https://fshs-ut.edu.al/?page_id=7097) | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| | |
|---|--|
| Standardi V.3 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Informimi i studentëve lidhur me programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen, kohëzgjatjen, lëndët/modulet që zhvillohen dhe syllabuset e tyre, së bashku me detyrimet semestrale dhe strukturën akademike të programit, i ofrohet studentëve, që kur kontaktojnë për të shprehur interes rreth programit Edhe nga takimi me studenten u vu re se ato ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| | <p>organizimin e programit të tyre nëpërmjet informimit online (<i>Ref. Takim me studentët e programit të studimit</i>). Këto struktura mundësojnë informacion në lidhje me strukturën dhe organizimin e programit të studimit. Gjithashtu, web-faqja e PoSIG dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit ka informacion të detajuar për programin dhe sqaron mënyrën e funksionimit të programit. Programi është organizuar në module dhe lëndë të vlerësuara në kredite (ECTS). Gjuha e mësimdhënies është anglishtja. Numri i krediteve të nevojshme për të përfunduar studimet është 120 ECTS, që i korespondojnë 4 semestrave studimor. Mobiliteti Ndërkombëtar është një ndër aspektet kryesore të programit, që mundëson studentëve t'i ndjekin studimet e tyre në të paktën 2, dhe më së shumti në 4 Universitete Partnere (<i>Ref. Dok. 3.15 - PoSIG Marrëveshja e programit; RVB, fq. 48; Takim me GVB</i>).</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes platformës LMS dhe stafit akademik që realizon programin. Info për studentët ofrohet edhe online në faqen e internetit ku gjendet informacion në lidhje me programin e studimit (<i>Ref. Faqa zyrtare e programit: https://www.posig.uet.edu.al dhe http://europeps.org/curriculum/</i>).</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit nëpërmjet Zyrës së Karrierës. Zyra informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës (<i>Ref. Dok. 2.25 – Rregullore e Zyrës së Karrierës; Takim me Përfaqësues të Zyrës së Karrierës</i>).</p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Koordinatori i departamentit mban kontakte të rregullta përmes postës elektronike me studentët që ndjekin programin e studimit në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në FSHS (<i>Ref. Dok. 3.3 Rregullore e departamentit; Takim me Stafin Akademik; Takim me Studentët</i>).</p> |
| <p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> | <p>Sistemi LMS (Moodle) mundëson lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor (<i>Ref. Dok. 1.15 Udhëzues UT per perdorimin e sistemit te mesimit ne distance. RVB, fq. 49</i>).</p> |
| <p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe</p> | <p>Gjithë informacioni, dokumentacioni dhe rekordet i studentit, që nga fillimi i studimeve deri në përfundim të programit e</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|---|-----------------------|-----------------------|
| aktivitetin mësimor të studentëve | studimit ruhen në Sekretarinë mësimore (Ref. Dok 2.9 Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Takim me Sekretarinë Mësimore). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht |
| | | | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


| Standardi V.4 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar. Ndërsa për programin PoSIG informacionet për studentët e diplomuar ruhen si në FSHS ashtu edhe pranë universitetit të Salzburg që është koordinator i PoSIG (Ref. Takim me Sekretarinë mësimore). |
| Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. | Institucioni disponon statistika të vjetore për numrin e studenteve të regjistruar në këtë program studimi, ndonëse UT është përgjegjës vetëm për provimet e dhëna në UT sipas kurseve të planifikuara atje. (Ref. Dok 2.9 Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Takim me Sekretarinë mësimore). |
| Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Institucioni disponon për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat vetëm për vitin e dytë që zhvillohet në UT. Rekomandohet që në kontakt me Universitetin e Salzburgut të merren të gjitha rekordet e përparimit të studentit, së bashku me rekordet që ndjek në universitetet partnere (Ref. RVB 49; Takimi me Sekretarinë Mësimore). |
| Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Të dhënat statistikore ruhen në Universitetin e Salzburgut. Duhet bërë përpjekje që këto të dhëna të ruhen edhe në UT, pasi informacioni i disponuar është i pjesshëm dhe i paplotë. (Ref. RVB, fq. 49). |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e | Monitorimi periodik i studentëve menaxhohet nga Universiteti i Salzburgut dhe UT ka informacione vetëm për studentët që kryejnë vitin e dytë pranë FSHS. Kjo nuk krijon mundësinë e një vlerësimi të plotë dhe koherent. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Bazuar në Statutin e universitetit studentët përfshihen në disa struktura si: Senati Akademik; Këshilli i studentëve/Këshillat e studentëve në nivel njësie kryesore; 1 student në Këshillin e Etikës; dhe 1 student në KPSC. Studentët gjithashtu angazhohen për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve (Ref. Dok. 1.2 - Statuti UT; Rregullore UT). |
| Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Kontributi i studentëve është konkret në disa struktura të UT lidhur me vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Ata bëhen pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. <i>Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Rekomandohet të bëhen analiza periodike mbi përfshirjen e të studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik (Ref. RVB, fq. 59; Takim me përfaqësues të KPSC-së).</i> |
| Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme. | Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit PoSIG është vërejtur një ndarje e balancuar dhe barabartë e ngarkesës mësimore në të 4 semestrat (30 ECTS për semestër). Ndyshimet në program (riorganizimi) është bërë konform akteve ligjore në fuqi. Semestri i fundit i dedikohet punimit të diplomës, në mënyrë që studentën të kenë kohën e nevojshme për t'iu përkushtuar përfundimin e e punimit të diplomës (Ref. Dok. 4.2 - Kurrikulat e PoSIG). |
| Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e | Institucioni organizon fokus grupe, pyetësorëve online dhe mbledhje të departamentit në formatin e hapur për studentët. Ata shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në lidhje me programin. Ka patur edhe raste të ndryshimit të Planit mësimor të programit PoSIG për tu ardhur në ndihmë studentëve. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| tyre në to. | Në takimin me studentët dhe pdegaogët, u sugjerua të organizohen aktivitete që janë specifike për studentët e programit (Ref. Dok. 1.13 Manuali i vlerësimit te performances se persnolit akademik-i UT; Takim me Stafin Akademik; Takim me studentët). | | |
| Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës | Rregullore e UT përcakton procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t'i drejtojë Shefit të Departamentit brenda 24 orësh një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Në rast se shefi i Departamentit nuk mund ta zgjidhë ankesën, atëhere Dekani ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Studentët kanë mundësi të parashtrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularin përkatës (Ref. Dok. 2.27 – Informacion per bazen rregullatore te ankimit te studenteve; Takim me Sekretarinë Mësimore). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi V.6 | |
| Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Stafi merr pjesë në aktivitete ose konferenca që nxisin kërkimin shkencor si në kudin e programit POSIG për shembull në Lubljanë, Vjenë, Pavia, ashtu edhe në pjesëmarrjen në programt Jean Monnet dhe në Ersamus+. Stafi i kushton një vëmendje të veçantë pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare–në momentin e vizitës përgjegjsja e programit merrte pjesë në një konferencë ndërkombëtare në kuadër të programit Jean Monnet, ndërsa UT ka vënë në dispozicion një fond të vecantë për kërkimin shkencor që mundëson aplikimin për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare (Ref. Dok. 4.5 - Te dhëna mbi aktivitetet kualifikuese dhe kërkimit shkencor të personelit akademik 2017-2021; Takim me stafin akademik). |
| Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin | Institucioni, dhe Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve më Jashtë e FSHS kanë qenë shumë aktive në zbatimin e një sërë projektesh me Universitete të huaja. Vetë programi PoSIG është rezultat i |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | marrëveshjes që UT ka nënshkruar me universitetet partnere vendase dhe të huaja (Ref. Dok 3.4 Urdhëri për hapjen e programit të studimit; Takime me përfaqësues të Zyrës së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë). | | |
| Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. | Personeli akademik kushton vëmendje të veçantë kërkimit shkencor, por mungon bashkëpunimi i stafit akademik me studentët në këtë drejtim. Sugjerohet fillimi i një projekti hulumtues në fushën e studimeve të Integritit dhe Qeverisjes që mund të kontribuojë në përfshirjen e studentëve në punime shkencore (Ref. Takim me GVB). | | |
| Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | Institucioni inkurajon stafin akademik për publikimin në revista shkencore ndërkombëtare me një fond në dispozicion prej 75.000 euro. Por kjo nxitje nuk është e vlefshme për studentët e programit. Universiteti gjithashtu inkurajon stafin e tij që të botojnë kërkimet e tyre në revistën e universitetit "Politikja" (Ref. Dok. 4.8 Cv e personelit akademik dhe ndihmesakademik; RVB, fq. 51; Takime me GVB; Takim me Stafin Akademik). | | |
| Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | Institucioni nuk ka dhënë informacion mbi këtë kriter. Sidoqoftë, programi PoSIG nuk është i drejtuar drejt studime inovative dhe patentave (Ref. RVB, fq. 51). | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Teza është një projekt kërkimor individual, që supervizohet nga dy udhëheqës (1 nga UT dhe 1 nga universiteti partner). Studentët gjithashtu ndjekin seminarin e tezës që ka për qëllim të ndihmojë studentët të zhvillojnë tezën e tyre. Përveç kësaj, nëpërmjet seancave metodologjike studenti ka asistencën e nevojshme në kuadër të realizimit të diplomës (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marreveshja e programit pika 4. Exams, Master's Thesis and Master's Thesis Defence; Takim me studentët). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |

| | |
|--|---|
| Standardi V.7 | |
| Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. | Institucioni është i fokusuar dhe i hapur ndaj bashkëpunimit kombëtar dhe ka zyra të dedikuara dhe efektive për këtë bashkëpunim si në fushën e mobilitetit ashtu edhe në menaxhimin e projekteve. Njëkohësisht, UT dhe FSHS kanë |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | <p>marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm publikë dhe privatë. Ata kanë marrëveshje dhe bashkëpunime me aktorë të rëndësishëm. Programi i studimit PoSIG është një platformë që e ka ndërtuar ura bashkëpunimi me institucione të tjera akademike në vend (Universiteti Evropian i Tiranës). Mobiliteti i studentëve mes universiteteve partnere të programit PoSIG është i garantuar, pasi është kusht për përfundimin e studimeve (Ref. Dok. 3.15 - PoSIG_Marreveshja e programit; RVB, fq. 51; Takime me GVB, me stafin akademik dhe me studentët).</p> |
| <p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p> | <p>Përfundimi i programit PoSIG u mundëson studentëve vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë/doktoratë. Programi PoSIG është i organizuar në Nivelin 7 të kornizës evropiane dhe kombëtare të kualifikimeve, e cila nga ana tjetër lehtëson vazhdimin e studimeve në Nivelin 8, d.m.th. në doktoratë. Gjithashtu studentët e programit PoSIG zhvillojnë lëndë të metodave të kërkimit dhe seminar për shkrimin e Tezës së diplomës që i ndihmojnë të përgatiten për studime të doktoratës (Ref. Dok. 4.2 Programet mesimore të lendeve; RVB, fq. 52; Takime me GVB dhe me studentët).</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p> | <p>Projektet ndërkombëtare janë fushat ku institucioni ka punuar në bashkëpunim me partnerët e tjerë të programit, sidomos në projektet e mobilitetit për studentët dhe pedagogët (Ref. Dok. 3.20 Të dhëna për mobilitetin e studenteve dhe të pedagogëve; Dok. 4.6 Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit). Në këtë drejtim, është bërë përpjekje që të përfshihen studiues të rinj në zbatimin e projekteve kërkimore dhe në organizimin e konferencave ndërkombëtare (Ref. Dok. 4.5 Te dhëna për aktivitetet për kualifikimin për kërkim shkencor të personelin akademik për 5 vitet e fundit.pdf RVB, fq. 52; Takime me GVB dhe me Stafin Akademik).</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p> | <p>Përfshirja e profesorëve të huaj është bërë e mundur në kuadrin e programit Erasmus + që mundëson stafi akademik i huaj të kalojë një periudhë kohe si pjesë e mobilitetit të tyre në UT (Ref. RVB, fq. 52; Dok. 4.6 - Lista e Projekteve).</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p> | <p>Studentët e programit PoSIG kanë mundësi mobilitetit me universiteteve partnere në BE dhe në Ballkanin Perëndimor si përshkruhet në Marrëveshjen e Konsorciumit Shtojca 1 dhe 2. (Ref. RVB, fq. 52; Dok. 3.15 - PoSIG_Marreveshja e programit).</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për</p> | <p>Programi ka një integrim të vazhdueshëm të pedagogë të huaj në mësimdhënie pasi ato janë pjesë integrale e programit, në</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | kuadër të programit të përbashkët të masterit. Më tej UT organizohen disa thirrje në vit për akademikët për t'u angazhuar në mësimdhënie në kuadrin e programit Erasmus + gjatë ose për të marrë pjesë në konferencat shkencore që zhvillohen te UT. Frekuenca e këtyre thirrjeve ndryshon por secila thirrje publikohet nga zyra e projekteve dhe vihen në dispozicion të pedagogëve (Ref. Dok. 3.20 <i>Te dhena per mobilitetin e studenteve dhe te pedagogeve; RVB, fq. 52</i>). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi V.8 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Institucioni ka zyrën e Karrierës dhe Sekretarisë Mësimore, të cilat realizojnë informimin, mbështetjen dhe ndjekjen e studentit gjatë vijimit të studimeve në vitin e dytë. Përsa i takon informacioneve lidhur me aktivitetet didaktike në vitin e parë, të studimit, apo aktivitetet e tjera të lidhura me PoSIG, ato realizohen në bashkëpunim me Universitetin e Salzburgut (Ref. Dok. 2.25 <i>Rregullore e shërbimit te karrieres; RVB, fq. 52; Takim me përfaqësues të Zyrës së Karrierës</i>). |
| Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Stafi akademik i UT në program përdor platformën Teams, e cila shërben si burim primar për konsultimin e dokumentave, informacionit dhe këshillimit rreth mundësive të studimit, që nga momenti i regjistrimit, si edhe për komunikimin lidhur me aktivitetet me interes të përbashkët. Studentët dhe pedagogët, mund të komunikojnë edhe përmes platformës Mhara të mundësuar nga PoSIG (Ref. Dok. 1.15 <i>Udhëzues UT per perdorimin e sistemit te mesimit ne distance; RVB, fq. 63</i>). |
| Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, | Në nivelin e UT funksionon “Zyra e Karrierës”, e cila zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti që janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit e këshillimit të karrierës. Studentët e interesuar kanë mundësi të marrin shërbim sipas |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al




| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | orareve të shpallura të pritjes, gjithashtu kontaktet e personave që këshillojnë janë publikë. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht (Ref. Dok. 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës; RVB, fq. 53; Takim me përfaqësues të zyrës së karrierës). | | |
| Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | Institucioni nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës disponon të dhëna të tillë. Zyra në detyrat e saj ka gjurmimin e studentëve pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin. Kjo listë përditësohej periodikisht pasi të diplomuarit kontaktohen rregullisht për të marrë info mbi statusin e tyre të punësimit për studentët që kanë mbaruar studimet dhe punësimi i tyre është 100% (Dok. 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës Ref. RVB, fq. 53; Takim me përfaqësues të zyrës së karrierës). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | | | |
|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE


| | |
|---|--|
| Standardi VI.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT strukturat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si edhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara si p.sh. “Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT”, “Manuali i Cilësisë”, si edhe “Paketa e instrumentave cilësorë”. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Komiteti i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSC). Për më tej PoSIG zbaton me sukses nëpërmjet Njësisë kryesore të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Salzburgut edhe |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | procedurat e IQA (Internal Quality Assurance), Manualin e Mësuesve si edhe Manualin e Studentëve (Ref. RVB, fq. 53; Dok. 1.2 - Statuti UT; Takimi me përfaqësues të KPSC). | | |
| Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertët të jashtëm. | KPSC në nivel institucioni së bashku me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në FSHS të përbërë nga Komiteti i Perhershëm i Sigurimit të Cilësisë ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. Institucioni nuk angazhon ekspertët të jashtëm pranë KPSC-së. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila mbështetet edhe në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të UT falë kontributin e personelit akademik dhe të studentëve nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit. Për më tej Njësia e Sigurimit të Cilësisë të FSHS dhe grupi i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit i bashkëngjiten në një sistem të dyfishtë kontrollit të cilësisë së programit PoSig si është shpjeguar më lart (Ref. Dok. 1.2 - Statuti i UT, Neni 41 dhe Kreu X; Dok. 1.6 - Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 15-27; Takimi me përfaqësues të KPSC). | | |
| Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni gjithashtu i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare. Programi i studimit PoSIG është i akredituar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin në Austri (Ref. 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS; RVB, fq. 54; Takimi me përfaqësues të KPSC). | | |
| Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit | Bazuar në Manualin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe përmes planit të veprimit të përvitshëm të hartuar nga struktura përgjegjëse KPSC programohet puna dhe ndiqn procedura periodike për kontrollin e cilësisë. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë por edhe atyre të Universitetit të Salzburgut që koordinojnë programin (Ref. RVB, fq. 54; Takimi me përfaqësues të KPSC). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |


Standardi VI.2
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.


| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë. | Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KPSC-ja. Në nivel njësie bazë është Departamenti i cili ka programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve. Njësia e Sigurimit të Cilësisë në UT, Zv. Dekani për programet e Studimit dhe Koordinatori i PoSIG koordinojnë punën për monitorimin dhe rishikimin e programit për të ruajtur nivelin e cilësisë (Ref. Dok. 1.2 - Statuti i UT, Neni 41 dhe Kreu X; Dok. 1.6 - Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 15-27; Dok. 1.11 - Manuali i cilesise; Dok. 1.14 - Paketa e instrumentave të cilësisë). |
| Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë. | Për të vlerësuar veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore, Institucioni përmes KPSSC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Gjithashtu shikohen deri në masën 20% edhe syllabuset përpara fillimit të vitit akademik dhe pasi diskutohet në nivel departamenti ky informacion i dërgohet Dresjtorisë së Kurrikulave dhe Cilësisë në nivel Rektorati, si struktura përgjegjëse për miratimin e projekt-programeve të paraqitura. (Ref. Dok. 1.2 - Statuti i UT neni 10; Takimi me Stafin Akademik; 2.16 Informacion për politiken e zhvillimit dhe të përmirësimit të programeve të studimit; Takimi me përfaqësues të KPSC). |
| Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. | KPSC përmes planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit duke përdorur pyetësorët dhe vlerësimet e studentëve, vetëvlerësimin e pedagogëve, formularin e veprimtarisë kërkimore shkencore për secilin pedagog, analizat vjetore të departamentit, etj (Ref. Paketa e Instrumentave të Cilësisë UT). Mbi këtë bazë KPSC harton një raport vjetor institucional me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e cilesisë (Ref. Dok. 1.6 - Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT). |
| Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Raportet e realizuara nga KPSSC-ja, ku përfshihet edhe vlerësimi i personelit ndihmës dhe jo vetëm atij akademik, janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formën e një raporti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse (Ref. 2.14 Rregullore e sigurimit të cilesise FSHS; Takimi me përfaqësues të KPSC). |
| Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin | Si u shpjegua më lart, trajtimi i rezultateve të vlerësimit në institucion bëhet në disa nivele dhe në bashkëpunim me koordinatorin e programit PoSIG. Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|---|---------------------|----------------------|
| e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga KPSC-ja (Ref. Takimi me përfaqësues të KPSC). | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi VI.3 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Në kuadër edhe të procesit të akreditimit të programeve, NJSBC kryen monitorimin e programeve në mënyrë periodike dhe harton një raport vjetor, i cili përfshihet në vetëvlerësimin institucional, por edhe ofron informacionin e nevojshëm për KPSC për të realizuar vlerësim në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. (Ref. Dok. 1.6 - Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT; Takimi me përfaqësues të KSBC). Në bashkëpunim edhe me Universitetin e Salzburgut hartohen edhe relacione specifike vlerësimi në bazë programi. |
| Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | UT përdor disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimit si: ai semestral me anë të sistemit LMS nga studentët, tërheqja e mendimit nga fokus-grupet, realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu që angazhohet në mësimdhënie; vlerësimi i performancës akademike të pedagogëve; Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit; diskutime me stafin. (Ref. Dok. 1.14 - Paketa e Instrumentave të Cilësisë së UT; Takimi me përfaqësues të KSBC). |
| Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Një sërë metodash përdoren nga institucioni për të kryer procesin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programit të studimit duke u bazuar në Manualin e Pedagogëve dhe Manualin e Studentëve si për shembull: provimet, silabuset, literatura e përdorur, etj. Realizohen monitorime edhe nga ana e eprorëve. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit, ku përfshihet edhe vlerësimi i praktikave mësimore dhe vlerësimi që japin studentët për procesin mësimor nga sistemi LMS janë të tjerë instrumente të përdorur për këtë qëllim. Format i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj. Këto analiza vihen në dispozicion të institucionit për të hartuar përmirësimet e mëtejshme (Ref Dok. 1.14 - Paketa e Instrumentave të Cilësisë UT). |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | |
|---|--|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p> | <p>Institucioni nëpërmjet NJSBC përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi si: pyetësorë dhe vlerësime të studentëve sipas formateve të përcaktuara në paketat e Instrumentave të Cilësisë UT; fokus grupe, raportet e vetëvlerësimit të stafit akademik. Në bashkëpunim me Universitetin e Salzburgut, programi kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes sistemit LMS (sondazh me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët) (Ref. RVB fq. 56; Dok. 1.14 - Paketa e Cilësisë UT).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| <p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p> | |
|--|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Megjithëse nuk ka një ekspert të jashtëm si anëtar të KSBC, institucioni përpiqet që të tërheqë mendimin e aktorëve të ndryshëm edhe jashtë universitetit për të patur një trajtim më cilësor të disa temave specifike dhe ekspertize të specializuara që mund të nevojitet për studentët dhe këta perzgjedhen në varësi të programit të studimit ndërmjet institucioneve ku studentët kruejnë praktikën mësimore, ndërmjet partnerëve kombëtarë të institucionit dhe në rastin e programeve specifike si POSIG edhe nga mbështetja që japin partnerët institucionale të programit. (Ref. RVB, fq. 56; Dok. 1.2 - Statuti i UT, neni 139-140).</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë të angazhuara në sigurimin e cilësisë janë të përcaktuara në kuadrin ligjor funksional të UT, në dokumentacionet ndihmëse që rregullojnë veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si edhe mbi Manualin e Cilësisë së PoSIG, të cilat përcaktojnë detyrat specifike të të gjithë stakeholders dhe strukturave të angazhuara në këtë program. Sigurimi i cilësisë së programit (Ref. Dok. 1.6 - Rregullore e Sigurimit të Cilësisë UT Kreu II; Dok. 3.16 - Manuali i Sigurimit të Cilësisë së PoSIG; Dok. 1.11 - Manuali i Sigurimit të Cilësisë së UT).</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al




| | | | |
|---|---|----------------------------|-----------------------------|
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Përfshirja e njësisë bazë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, personelit akademik dhe atij ndihmës, studentëve të programit apo aktorëve të tjerë si parashikohet në rregulloren e UT ndihmon në procesin e një vlerësimi shumëplanësh të cilësisë dhe është një parakusht për garantimin e cilësisë (Ref. Dok. 1.6 - Rregullore e Sigurimit të Cilësisë UT Kreu II; Dok. 3.16 - Manuali i Sigurimit të Cilësisë së PoSIG; Dok. 1.11 - Manuali i Sigurimit të Cilësisë së UT). Megjithatë, procesi i vlerësimit dhe analizimit të PoSIG mbetet i centralizuar tek Universiteti i Salzburg, fakt që limiton rolin e departamentit përkatës në vlerësimin e përgjithshëm të programit (jo vetëm për kurset e zhvilluara në UT).</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Vlerësimi është transparent dhe siguron të dhëna në respekt të integritetit akademik te personelit akademik dhe studentëve, falë angazhimit të aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit periodik (RVB. fq. 57; Takimi me përfaqësues të KPSC). Megjithatë një këndvështrim i plotë mbi vlerësimin e programit në nivel partnerësh ndërkombëtarë dhe njehsimi i plotë i këtyre praktikave me ato në nivel institucional, mbetet akoma për tu realizuar plotësisht.</p> | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p> | <p>Institucioni nuk angazhon ekspertë të jashtëm në strukturën e KPSC, por mendimi i tyre thithet nëpërmjet takimeve me ekspertë për tema specifike dhe në përmirësimin e mëtejshëm të syllabusve, si edhe nga kontributi që vjen nga vlerësimi i praktikave profesionale (Ref. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 33; Takimi me përfaqësues të KPSC).</p> | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> |
| | | X | |


| <p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p> | |
|---|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>Procesi i kontrollit të brendshëm të cilësisë funksionon në bazë të një plani veprimi vjetor dhe është publik si përsa i takon procedurës së zbatuar ashtu edhe raporteve të përpiluara. Procesi është gjithëpërfshirës dhe integruar duke përfshirë edhe studentët (Ref. Dok. 1.6 - Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 5, pikat 6-7; Takimi me përfaqësues të KPSC).</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Vlerësimi është në nivel institucional, dhe rezultatet e tij vihen në dispozicion të strukturave drejtuese falë disa mekanizmave si: komunikimi i organeve përkatëse për raportet e monitorimit; publikimi i raporteve të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm; vendimet e akreditimit institucional bëhen publike, raportet e vlerësimeve për stafin akademik dhe ndihmës u komunikohen personave të interesuar, etj. Rezultatet e vlerësimit të programit vihen gjithashtu në dispozicion të publikut (<i>Ref. Dok. 1.6 - Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 2</i>).</p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>Institucioni realizon një proces vazhdueshëm të monitorimit dhe analizës së rezultateve si edhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe janë dispozicion drejtuesve të institucionit, paraqitur në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat pas përpunimit shfrytëzohen për të vlerësuar efikasitetin e masave të marra për përmirësimin e punës dhe i komunikohen drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik (<i>Ref. Dok. 1.6 - Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT; Takimi me përfaqësues të KPSC</i>).</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Departamenti harton një raport vjetor, ku reflekton mbi situatën dhe rezultatet e arritura nga hapat e ndërmarrja. Duke shqyrtuar rezultatet e vlerësimit, harton masat që lidhen me programet e studimit që ai mbulon. Këtu përfshihen vlerësimi për cilësinë e programit, mësimdhënies, kërkimit shkencor, menaxhimit dhe shërbimeve ndaj studentit. Në bazë të kësaj analize jepen edhe rekomandimet përkatëse, të cilat në bazë të nivelit që trajtojnë përfshihen në planet e punës së departamentit apo në drejtimin strategjik të institucionit (<i>Ref. Dok. 3.18+ Raport për veprimtarinë e programit të studimit; RVB, fq. 82; Takimi me përfaqësues të KPSC</i>).</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p> | <p>Përfshirja e të gjithë aktorëve të interesuar në realizimin dhe më pas kominkimin e rezultateve të vlerësimit të përvitshëm nga ana e KPSC-së siguron një komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe stafin për këtë qëllim. Për të përmirësuar më tej këtë proces janë organizuar trainime dhe seanca informuese nga GVB-të e UT me ndihmën edhe të KPSC, dhe Drejtorisë së Kurrikulave në Rektorat. Rezultatet e këtyre trainimeve, si edhe grupeve të punës të ngritura për tematika të caktuara të sigurimit dhe përmirësimin e cilësisë i bëhen të ditur si stafit akademik ashtu edhe studentëve nëpërmjet platformës Teams (<i>Ref. RVB, fq. 58; Takimi me përfaqësues të KPSSC</i>).</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkenvave në “Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

- 1) Programi i studimit është rezultat i bashkëpunimit me universitete evropiane dhe rajonale dhe zbatimit të politikave studimore dhe shkencore evropiane. Ofrimi i një programi studimi të përbashkët me universitete Evropiane partnere, mundësia e ndjekjes së studimeve për një vit akademik në të paktën 2 universitete partnere si dhe pajisja e studentit në përfundim të studimeve me diplomë të përbashkët nga 2 deri në 4 universitete të konsorciumit.
- 2) Programi i studimit i ofron mundësinë studentëve të profilizohen dhe specializohen në të paktën dy prej pesë moduleve të ofruara (Teoritë politike; Politika e Krahasuar; Administrata publike; Marrëdhënie ndërkombëtare; Integrimi European)
- 3) Angazhimi në mësimdhënie me pedagogë nga universitetet partnere të Salzburgut dhe Lubjanës, është një vlerë e shtuar e këtij programi studimi.
- 4) Përdorimi i platformës së studentëve ePortfolio është një praktikë e mirë e cila nxit ndërveprimin e studentëve midis institucioneve partnere.
- 5) Praktikë e mirë është edhe zhvillimi i një viti akademik në një universitet partner si dhe e-library e programit të studimit i mundësojnë studentit qasjen në një databazë literature më të plotë dhe të azhurnuar, e cila garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor të parashikuara për programin e studimit.

Pika të dobëta


- 1) Nuk ka një raport të përditësuar analitik të përfitimeve nga bashkëpunimi me universitetet partnere në funksion të realizimit të programit të studimit. Nuk është ofruar ndonjë praktikë konkrete të bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al





private, jashtë konkorciumit për përditësimin dhe riorganizimin e programit në fjalë.
(Standardi I.5/kriteri6)

- 2) Studimi i tregut për nevojat e programit nuk është përditësuar ndërkohë që programi i studimit ka përparuar. (Standardi II.4/Kriteri 9).

Rekomandime

- 1) Për një mbarëvajtje sa më të mirë të programit të studimit dhe për të siguruar një harmoni midis marrëveshje së programit me Universitetet partnere dhe akteve të brendshme të funksionimit të IAL-së, është e nevojshme krijimi i një rregullore specifike për programin e studimit.
- 2) Ka një studim tregu mbi arsyet e hapjes së programit, por mungon një azhurnim i tij i cili të përfshijë në mënyrë periodike të dhëna nga komunikimi zyrtar me bordin e tregut të Punës të Depratmentit, punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. Megjithatë, është e këshillueshme që për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, departamenti të analizojë dhe të përcjellë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, duke përfshirë në to mendimin e studentëve, personelit akademik, dhe aktorëve të tjerë për të ndërmarrë hapat e duhur për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit dhe për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter praktik dhe kërkesat e tregut të punës. Do të ishte një praktikë e mirë nëse do të kishte një vlerësim konkret për mundësitë reale në tregun e punës të programit të studimit Master i Shkencave Politike - Integrimi dhe Qeverisja.
- 3) Specifikisht për programin e studimit, IAL-ja ka një bazë me të dhëna të palëve të treta të interesuara, të cilët mund të përdoren për vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit.
- 4) Të zhvillohet një analizë mbi efektet dhe pritshmëritë për aplikimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe të zgjerohen mundësitë e trajnimit të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.
- 5) Sugjerohet fillimi i një projekti hulumtues në fushën e studimeve të Integritit dhe Qeverisjes që mund të kontribuojë në përfshirjen e studentëve në punime shkencore.
- 6) Këshillohet përfshirja e studentëve dhe strukturave të tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit.
- 7) Programi i studimit meriton një publicitet më të mirë në faqet e internetit të Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale.
- 8) Duhet të rritet numri i studentëve që ndjekin studimet për një semestër në IAL është i vogël dhe për këto nevojitet një përditësim i vazhdueshëm i studimit të tregut, i cili të përfshijë në mënyrë periodike të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.
- 9) Në faqen e website të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, informacioni duhet të ofrohet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze. Programi i



studimit meriton një publicitet më të mirë në faqet e internetit të Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale.

- 10) Duhet të merren masa për të patur një ekspert të jashtëm për kontrollin e cilësisë në zbatim të ligjit përkatës.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in "Political Science - Integration and Governance" of the Institution of Higher Education "European University of Tirana"

Strengths and affirmations

- 1) The study program is the result of cooperation with European and regional universities and the implementation of European study and scientific policies. Providing a joint study program with European partner universities, the possibility of pursuing studies for an academic year in at least 2 partner universities and equipping the student at the end of studies with a joint degree from 2 to 4 consortium universities.
- 2) The study program offers students the opportunity to profile and specialize in at least two of the five modules offered (Political Theories; Comparative Politics; Public Administration; International Relations; European Integration)
- 3) The engagement in teaching by pedagogues from the partner universities of Salzburg and Ljubljana, is an added value of this study program.
- 4) Using the ePortfolio student platform is a good practice which encourages student interaction between partner institutions.
- 5) Good practice is also the development of an academic year in a partner university and the e-library of the study program enables the student to access a more complete and updated literature database, which guarantees the acquisition of the necessary knowledge and insights, as well as the scientific research foreseen for the study program.

Weaknesses

- 1) There is no updated analytical report on the benefits of cooperation with partner universities in order to implement the study program and there is no concrete practice of cooperation with research and scientific institutions, public and private, outside the consortium to update and reorganize the program. **(Standard I.5/kriteri6)**
- 2) The market study for the needs of the program has not been updated while the study program has progressed. **(Standard II.4/Criterion 9).**


Recommendations

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



- 1) For the best possible progress of the study program and to ensure a harmony between the agreement with the partner Universities and the internal acts of the functioning of the HEI, it is necessary to design a specific regulation for the study program.
- 2) There is a study conducted of the reasons for opening the program, but it lacks an update which periodically would include data from the official communication with the labor market board of the Department, employers in the field, their requirements and needs, opportunities and student employment, data on real student employment and expected developments in the relevant sector. However, it is advisable that in order to better adapt to the demands of the labor market, the department analyses and conveys the proposals of associates and partners from the labor market, so to take measures for further development of the study program and to reflect in them contemporary developments of a practical nature and the demands of the labor market. It would be a good practice to have a concrete assessment of the real opportunities in the labor market of the Master of Political Science study program - Integration and Governance.
- 3) Specifically for the study program, the HEI has a database of data of interested third parties, which can be used to establish cooperation agreements in order to achieve the objectives of the study program.
- 4) To conduct an analysis on the effects and expectations for the application of new methods in teaching and to expand the training opportunities of academic staff to improve teaching skills and implement new methods.
- 5) It is suggested to start a research project in the field of Integration and Governance studies that can contribute to the involvement of students in scientific papers.
- 6) It is advisable to involve students and their structures in order to improve the study program.
- 7) The study program deserves better publicity on the websites of the University of Tirana and the Faculty of Social Sciences.
- 8) The number of students pursuing studies for one semester in the HEI needs to be increased and a constant update of the market study conducted periodically and including data provided by official communication with employers in the field would help in achieving this objective.
- 9) On the websites of the University of Tirana and the Faculty of Social Sciences, the information provided about the study program needs to be broader and provided in English and in the Albanian language. The study program deserves better publicity on the websites of the University of Tirana and of the Faculty of Social Sciences.
- 10) The quality control is institutionally carried out only by internal stakeholders. In line with the current regulation the institution needs to take the necessary measure to have an external member of the quality control structures as foreseen in the law.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|----------------------|---------------------|----------------------|
| | | Përbushen pjesërisht | Përbushen kryesisht | Përbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al